

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5745
E premte, 5 prill 2019
çmimi 0.40 €

Fillon projekti i madh për ndërtimin e spitalit të Prishtinës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMAJL KURTESI | FAQE 4-5

Duhet të zëvendësohen orët e humbura gjatë grevës

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurtesi, ka thënë se nxënësit kanë mbetur pengë të mosmarrëveshjeve në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK). Sipas tij, këto mosmarrëveshje në mes të këtyre dy palëve janë më tepër çështje inatësh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", Kurtesi ka thënë se orët e humbura gjatë grevës trejavëshe duhet të zëvendësohen. Ai ka vlerësuar se në aspektin ligjor sindikata ka të drejtë por, për hir të nxënësve, duhet të pranojë që t'i zëvendësojë orët. Për këtë gjendje të krijuar Kurtesi ka thënë se fajin kryesor e kanë qeveria dhe Ministria e Arsimit madje, sipas tij, do të duhej të jepnin dorëheqje ministri dhe kryeministri



Turqia konfirmon përkrahjen për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Rrustem Berisha, ka pritur të enjten në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes së Turqisë, Hulusi Akar, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet dy ministrive si dhe të dy ushtrive përkatëse, duke evidentuar mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejshëm edhe në të ardhmen. Në fund të takimit të dy ministrat, Berisha dhe Akar, nënshkruan



marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dy ministrive | FAQE 5

Kurti paralajmëron protesta dhe mocion kundër qeverisë



AKTUALE

AFORIZMA PËR DIPLOMATIN DHE POLITIKANIN (IV) F. 11

Prof. Lisen BASHKURTI



HARADINAJ: I MIRËPRESIM KRITIKAT NGA SHOQËRIA CIVILE, POR KJO QEVERI NUK ËSHTË QEVERI QË VAJTON F. 6



EKONOMI

SERBIA NUK KA BAZË PËR TA DËRGUAR KOSOVËN NË ARBITRAZH! F. 11



Shkruan: Endrit SHALA

KRYESHEFI I TELEKOMIT FILLON VIZITAT NËPËR REGJIONE, NIS ME GJILANIN F. 6

VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR HEQJEN E TARIFAVE ROAMING F. 6



SPORT

HAJDARI: TË DIELËN DO TË KETË FESTË NË 'FADIL VOKRRI' F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

NATO-ja shënon 70-vjetorin, e gatshme të përballet me kërcënimet e sigurisë



sigurinë atje.

Në 60-vjetorin e saj, NATO-ja u zgjerua me përfshirjen e Kroacisë dhe Shqipërisë, ndërsa në vitin 2017 Mali i Zi u bë anëtar i 29 i saj. Tashmë në rrugë për t'u bërë anëtare e NATO-s është edhe Maqedonia e Veriut.

Rusia nuk i sheh me sy të mirë anëtarësimet e reja në NATO dhe ajo është tema kryesore e takimit të ministrave të jashtëm të NATO-s në Uashington derisa po shënohet përvjetori i 70 i aleancës. Ministrat pritet të miratojnë një paketë masash për ta përmirësuar mbrojtjen e NATO-s në Detin e Zi.

Mes temash do të jetë edhe misioni i NATO-s në Afganistan, ku ajo është angazhuar që në vitin 2001, kur edhe u shënuar rasti i parë i aktivizimit të artikullit 5 të NATO-s pas sulmeve të 11 shtatorit. Neni pesë do të thotë që sulmi ndaj një vendi anëtar është sulm ndaj gjithë NATO-s.

Ministrat pritet të diskutojnë edhe planet e Turqisë për të blerë një sistem raketash kundërajrore ruse S-400, plane që kanë nxitur reagimin e rreptë të Shteteve të Bashkuara, por edhe aleatëve evropianë.

Ministrat e jashtëm të vendeve aleate të NATO-së u takuan në samitin e tyre në Uashington për ta shënuar 70-vjetorin e themelimit të aleancës. Në urimet e tyre me rastin e 70-vjetorit të Aleancës Veriatlantike, presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë shprehur aspiratën dhe dëshirën që edhe Kosova të jetë në NATO

NATO-s. Jugosllavia e atëhershme nisi të shpërbëhej dhe rajoni u përfshi nga lufta civile, spastrimi etnik dhe gjenocidi.

Në 50-vjetorin e saj NATO-ja ndërmoi operacionin më të madh deri atëherë, duke

bombarduar forcat serbe për t'u dhënë fund mizorive të tyre ndaj shqiptarëve të Kosovës. Rreth 50 000 trupa hynë atëbotë në Kosovë për ta vendosur dhe ruajtur paqen, ndërsa edhe më tej mbi 4 000 trupa të NATO-s kujdesen për

Thaçi: Kosova, e gatshme të kontribuojë më shumë për paqen

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e 70-vjetorit të themelimit të NATO-s, ka thënë se kjo organizatë vazhdon të reflektojë më së shumti siguri, bashkëpunim dhe solidaritet për të gjithë. Ai ka thënë se Kosova është e gatshme të kontribuojë më shumë për paqen. "Në përvjetorin e 70 të themelimit të Aleancës Veriatlantike, me respektin dhe mirënjohjen më të thellë kujtojmë rolin e pazëvendësueshëm të saj për tërë botën. Si bashkësi e popujve dhe shteteve që punon pareshtur për forcimin e paqes, NATO-ja vazhdon të reflektojë më së shumti siguri, bashkëpunim dhe solidaritet për të gjithë. Jemi të lumtur që e kemi

NATO-n në Kosovë, por dëshirë jonë është që edhe Kosova të jetë në NATO. Rrugëtimin euroatlantik duam ta vazhdojmë si vend anëtar i NATO-s dhe për këtë po punojmë pandërprerë. Në rresht me të gjitha vendet anëtare të NATO-s, tashmë edhe Republika e Kosovës është e gatshme që të kontribuojë më shumë për paqen dhe stabilitetin në rajon, Evropë dhe botë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i ka dërguar telegram urimi shefit të Aleancës, Stoltenberg. "Në shënim të 70-vjetorit të nënshkrimit të Traktatit të NATO-s, në emër të popullit dhe Qeverisë së Kosovës, i kam

dërguar telegram sekretarit të përgjithshëm të Paktit Veriatlantik, Jens Stoltenberg, me urimet më të mira. Njëzet vjet më parë NATO-ja mbrojti të drejtat e popullit të Kosovës përballë një fushate gjenocidale të vrasjes dhe terrorit. Populli i Kosovës përherë do t'i jetë mirënjohës ShBA-së dhe shteteve anëtare të NATO-s. Tani, pas dy dekadave, si popull i lirë me orientim të natyrshëm dhe të palëkundur euroatlantik, ne synojmë që të jemi pjesë e aleancës së shteteve të NATO-s dhe ta japim kontributin tonë të plotë për mbrojtjen e vlerave dhe parimeve të sigurisë, lirisë dhe demokracisë", ka thënë Haradinaj.

PRISHTINË, 4 PRILL - Në Uashington u takuan ministrat e jashtëm të vendeve aleate të NATO-s për shënimin e 70-vjetorit të themelimit të aleancës. Ministrat pritet të miratojnë një sërë masash që synojnë përmirësimin e mbrojtjes së NATO-s në rajonin e Detit të Zi.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se NATO-ja duhet të jetë më e përshtatshme për t'u përballur me kërcënimet që ekzistojnë aktualisht në botë. "Ne duhet ta bëjmë më të përshtatshme aleancën tonë për t'u përballur me këto kërcënimet emergjente siç janë: agresioni në rritje i Rusisë, konkurrenca strategjike e Kinës, migrimi i pakontrolluar, sulmet kibernetike e të tjera", tha Pompeo në

hapje të takimit të ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s.

70 vjet të NATO-s

NATO-ja u themelua në prill të vitit 1949, pak vjet pas Luftës së Dytë Botërore dhe në prag të Luftës së Ftohtë. Ajo bashkoi fillimisht 12 vende, të Evropës Perëndimore me Kanadanë dhe Shtetet e Bashkuara, për t'u vetëmbrojtur nga kërcënimet e Bashkimit Sovjetik Deri në rënien e komunizmit kjo ishte sfida kryesore e aleancës perëndimore e cila u zgjerua nëpër vite. Pas rënies së murit të Berlinit, NATO-ja u zgjerua drejt Lindjes. Fillimi i viteve '90 vuri në sprovë aftësitë tradicionale mbrojtëse të

Imer Selmani nuk e mbështet Blerim Rekën

SHKUP, 4 PRILL - Blerim Reka, kandidat i pavarur në zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut, ka reaguar në lidhje me përfshirjen në fushatë të Imer Selmanit, "konsull nderi" në Republikën e Shqipërisë, me seli në Manastir. Në konven-

tën e kandidatit Stevo Pendarovskit, Imer Selmani me fjalimin e tij qendror prezantoi dhe mbështeti kandidaturën, me çka u përcaktua politikisht, ndërkohë që ushtron funksion konsullor. "Keqpërdorimi politik i pozitës si 'konsull nderi' i Republikës

së Shqipërisë, për interesa personale, nuk i bën nder as Republikës së Shqipërisë, as Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe as qytetarëve të këtij vendi", vlerësojnë në shtabin e Blerim Rekës, ka njoftuar Alsat. Për shkeljen në fjalë, kandidati i pavarur,

Blerim Reka, do të kërkojë takim me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Maqedoni, Fatos Reka, kurse nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë do të kërkojë shkarkimin e Imer Selmanit nga pozita "konsull nderi".



Nga sot (e premte) Lëvizja Vetëvendosje fillon tubimet me qytetarë

Kurti paralajmëron protesta dhe mocion kundër qeverisë

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se prej të premtes do t'i fillojnë përgatitjet për protesta kundër qeverisë. Sipas tij, PAN - qeveria është PAN - hajnia. Në një konferencë për medie, Kurti ka theksuar se në të njëjtën kohë Lëvizja Vetëvendosje do të punojë edhe për mocion të mosbesimit ndaj qeverisë, i cili do ta largojë këtë qeveri dhe do të mundësojë zgjedhje të parakohshme

kushtëzën, kurrsesi nuk bën të hiqet kjo taksë, ama nuk pranojmë që në emër të kësaj takse të legjitimohen zhvatja dhe keqqeverisja. Ashtu sikurse që pjesëmarrja në luftën çlirimtare nuk është leje për uzurpime të pasluftës, edhe taksa ndaj mallrave të Serbisë nuk mund të jetë biletë për vjedhjen e pasurive dhe buxhetit të Kosovës", ka vlerësuar Kurti.

Nuk ka mbledhje të kabinetit që prej formimit të PAN - qeverisë, sipas tij, ku nuk është marrë një vendim kundër interesit publik. "Ky kryeministër emëroi 23 ministra, mbi 80 zëvendësministra, pesë zëvendëskryeministra, e 35 këshilltarë, pa asnjë bazë të arsyeshme dhe në shpërfillje të nevojave e me shpërdorim të buxhetit. Zyrtarë politikë me aktakuza për keqpërdorim e korrupsion i ricikluan si ministra dhe zëvendësministra. Kërcënoi ish-prokurorin e vetëm që shprehu integritet profesional dhe guxim publik, Elez Blakajn", është shprehur Kurti.

Sherifi, Kurtit: Hipokrizia nuk ka brirë!

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka reaguar ndaj deklaratës së kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili koalicionin e PAN-it e ka quajtur koalicion të hajnisë. Sherifi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se porsa të "zbresësh" nga pushteti Kurti të ofron partneritet për të ardhur së bashku në pushtet. "Pushteti dhe hipokrizia e Albin Kurtit! Mjafton të jesh në pushtet që Albin Kurti të të shpallë 'hajn', 'kriminel', 'tradhtar' madje edhe 'argat i Serbisë'! Sapo të 'zbresësh' nga pushteti ku ke 'vjedhë', ku 'ke tradhtuar interesat e vendit duke bërë argatin e Serbisë', ai të vjen në shtëpi dhe të ofron partneritet për të ardhur së bashku në pushtet! Hipokrizia nuk ka brirë!", ka shkruar Sherifi.

Më tej, lideri i LV-së ka përmendur çështjen e demarkacionit me Malin e Zi, kontratën me "Contour Global", 53 milionë eurot për "Bechtel-Enkan", kapjen e ndërmarrjeve publike që, sipas tij, janë vetëm disa prej skandaleve të kësaj qeverie. "Premtuan uljen e papunësisë, sollën të kundërtën. U rritën ca e

për disa të ardhurat, por u zvogëluua numri i vendeve të punës, pra u rrit pabarazia. Asnjë kompani e madhe nuk u hap as në vitin 2017 e as në vitin 2018 në Kosovë. Dhe, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nuk po mbërrijnë të hapin vend të ri pune. PAN - qeveria është PAN - hajnia", është shprehur Kurti.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINE, 4 PRILL - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka paralajmëruar të enjten fillimin e protestave kundër qeverisë aktuale. Në një konferencë për medie, ai ka bërë me dije se prej të premtes do të fillojnë tubimet me qytetarë nëpër gjithë komunat e Kosovës për t'i përgatitur ata për protesta. Kurti ka thënë se me qeverinë aktuale është shtuar hajnia dhe është pakësuar durimi i qytetarëve të Kosovës. "Prej ditës së nesërme fillojmë me tubime me qytetarë, kundër PAN hajnisë dhe për zgjedhje të reja. Në orën 14:00, në Sheshin 'Adem Jashari', nesër, pra të premten, jemi në Vushtrri. Pasnesër, të shtunën, në orën 13:00, në Besianë (Podujevë), kurse në orën 15:00 në Mitrovicë. Vazhdojmë pastaj për çdo ditë anëmbanë nëpër qytetet e qytezat e Kosovës. Me këto tubime nëpër komuna gjithandej Kosovës shkojmë bashkë drejt protestave qytetare dhe mocionit të mosbesimit në Kuvend që e largon këtë qeveri dhe mundëson zgjedhjet e parakohshme demokratike për ndryshimet e domosdoshme politike, ekonomike dhe shoqërore", ka thënë Kurti.

Ai ka treguar se këto protesta do të jenë kundër kryeministrit dhe presidentit të vendit. "Kryeministrin dhe presidentin e Kosovës i ndan taksa ndaj Serbisë, por i bashkon korrupsioni në Kosovë. Dhe, ajo që i bashkon është më e fuqishme sesa ajo që i ndan, meqë po rrinë bashkë në pushtet. Prandaj, këta duhet të shkojnë bashkë. Ne kërkojmë dorëheqjen si të presidentit, po ashtu edhe të kryeministrit. 100 ditë në vitin 2004 Haradinajt mund t'i jenë dukur pak për ta

treguar veten, mirëpo këto gati 600 ditë në vitet 2017, 2018 dhe tash 2019 janë tepër shumë për të pasur çfarëdo dilema rreth tij", ka thënë ai, duke shtuar se korrupsioni, papunësia dhe migrimi po rriten, kurse investimet, rendimentet dhe arsimiti po bien. Sipas kreut të LV-së, taksa duhet të mbetet, por kjo qeveri duhet të shkojë. "Taksën e vendosën 10 për qind e mandej 100 për qind, pa plan, pa strategji, pa përlllogaritje e pa mbikëqyrje të zbatimit, në vend se të marrin vendim për reciprocitetin të plotë politik, ekonomik dhe tregtar ndaj Serbisë, nga i cili hoqën dorë. Sidoqoftë, tash që Vuçiqi na



Aktakuzë ndaj personit që kërcënoi kryeministrin Haradinaj

PRISHTINE, 4 PRILL - Prokuroria Speciale ka ngritur të enjten aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës ndaj të pandehurit B. E. nga Komuna e Drenasit për shkak të veprave penale "shtytje për kryerjen e veprave terroriste"

si dhe "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve". Sipas aktakuzës, i pandehuri B. E., më 23 gusht të vitit 2018, përmes një kanali në rrjetet sociale, ka postuar fotografi "me përmbajtje kërcënuese

ndaj kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, e ku në prapavijë shihet flamuri i organizatës terroriste ISIS". Sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale, i pandehuri B. E. nga muaji gusht i vitit 2018 e deri

në muajin janar të vitit 2019, si administrator i po të njëjtit kanal në rrjetet sociale, me anë të fotografive dhe videoincizimeve ka bërë propagandim në lidhje me organizatën terroriste ISIS, duke përkrahur haptazi veprimet e tyre

terroriste. Të njëjtit person, kur është ndaluar nga ana e Policisë së Kosovës, i është gjetur një armë e ftohtë, thikë luftarake, e përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve trupore dhe e njëjta i është sekuestruar.

Flet për "Epokën e re", Ismajl Kurteshi

Duhet të zëvendësohen orët

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurteshi, ka thënë se nxënësit kanë mbetur pengë të mosmarrëveshjeve në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK). Sipas tij, këto mosmarrëveshje në mes të këtyre dy palëve janë më tepër çështje inatësh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kurteshi ka thënë se orët e humbura gjatë grevës trejavëshe duhet të zëvendësohen. Ai ka vlerësuar se në aspektin ligjor sindikata ka të drejtë por, për hir të nxënësve, duhet të pranojë që t'i zëvendësojë orët. Për këtë gjendje të krijuar Kurteshi ka thënë se fajin kryesor e kanë qeveria dhe Ministria e Arsimit madje, sipas tij, do të duhej të jepnin dorëheqje ministri dhe kryeministri

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 PRILL - Kryetari i Komisionit për Arsim, Ismajl Kurteshi, ka thënë të enjten se, pavarësisht së drejtës ligjore, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) duhet të marrë vendim në të mirë të nxënësve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se duhet të zëvendësohen orët e humbura gjatë grevës trejavëshe. "Si komision, por edhe si Vetëvendosje kemi përkrahur ngritjen e koeficientit si dhe zëvendësimin e orëve të humbura. SBASHK-u ka të drejtë sepse, bazuar në Ligjin për Greva, mësimdhënësit nuk janë të obliguar t'i zëvendësojnë orët. Megjithatë, kemi kërkuar nga sindikata që, pavarësisht se ka të drejtë ligjore, të punojë për interesa të fëmijëve dhe t'i zëvendësojë orët. Presim nga sindikata ta rishikojë vendimin pas plotësimit të kërkesave dhe t'i zëvendësojë orët. Përndryshe, do të ndodhë që nxënësit në Republikën e Kosovës këtë vit shkollor ta kenë të mangët", ka deklaruar Kurteshi.

Ai ka thënë se nxënësit kanë mbetur pengë të mosmarrëveshjeve në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut dhe, sipas Kurteshit, këto mosmarrëveshje janë më tepër çështje inatësh. "Janë fëmijët ata që mua personalisht më bëjnë t'i lus SBASHK-un dhe MASHT-in që të merren vesh. Pres që te palët të mbizotërojnë arsyeja, t'i harrojnë inatet dhe të marrin vendim në interes të fëmijëve. MASHT-i ka gabimet e veta në këtë drejtim, madje ka humbur edhe autoritetin sepse vendimi nuk është bazuar në ligj. SBASHK-u është në rregull sa i përket aspektit ligjor, por vendimi duhet të jetë në interes të fëmijëve", është shprehur Kurteshi.

Për gjendjen e krijuar Kurteshi ka thënë se fajin kryesor e kanë qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe, sipas tij, do të duhej të jepnin dorëheqje ministri dhe



kryeministri. Madje Kurteshi ka thënë se edhe SBASHK-u nuk ka qenë konsistent në qëndrime dhe, sipas tij, kjo gjë nuk është në rregull.

"Epoka e re": Z. Kurteshi, në takimin e përbashkët të Komisionit për Arsim me përfaqësuesit e MASHT-it dhe SBASHK-të -ut ka pasur përafrim të qëndrimeve sa i përket çështjes së kompensimit të orëve të humbura gjatë grevës.

Kurteshi: Në takimin e përbashkët me ministrin Bytyqi, përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe të Këshillit të Prindërve, kemi kërkuar të arrihet një marrëveshje. SBASHK-u ka ardhur me dy kërkesa. Kërkesa e parë ka qenë për tërheqjen e vendimit të ministrit dhe ministri Bytyqi e ka tërhequr vendimin. Kërkesa e dytë ka qenë që Kuvendi ta fillojë procedurën e plotësimit

ndryshimit të Ligjit për Paga në të cilin do të barazohet koeficienti i mësuesve prej klasës së parë deri në klasën e pestë me mësuesit e ciklit më të lartë. Kërkesën e dytë si komision publikisht kemi premtuar se do ta plotësojmë. Pra, do t'i nisim procedurat për ta bërë plotësim-ndryshimin e Ligjit për Paga. Kërkesat e sindikatës janë plotësuar, prandaj kemi kërkuar nga përfaqësuesit e SBASHK-ut që ta informojnë Këshillin Drejtues që është organ vendimmarrës, se kërkesat do të plotësohen dhe janë krijuar kushtet që sindikata, ashtu siç ka premtuar, do t'i zëvendësojë orët. Mirëpo përfaqësuesja e sindikatës ka thënë se duan ta shohim vendimin e Kuvendit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Paga, por një gjë e tillë është e pamundur të ndodhë brenda një jave sepse ka procedura dhe ndryshimet nuk mund të bëhen

me një urdhër të prerë. Si komision, por edhe si Vetëvendosje kemi përkrahur ngritjen e koeficientit si dhe zëvendësimin e orëve të humbura. SBASHK-u ka të drejtë sepse, bazuar në Ligjin për Greva, mësimdhënësit nuk janë të obliguar t'i zëvendësojnë orët. Megjithatë, kemi kërkuar nga sindikata që, pavarësisht se ka të drejtë ligjore, të punojë për interesa të fëmijëve dhe t'i zëvendësojë orët. Presim nga sindikata ta rishikojë vendimin pas plotësimit të kërkesave dhe t'i zëvendësojë orët. Përndryshe, do të ndodhë që nxënësit në Republikën e Kosovës këtë vit shkollor do ta kenë të mangët.

"Epoka e re": Si e shihni zgjidhjen e këtij problemi dhe kush ka të drejtë, SBASHK-u apo MASHT-i? Kurteshi: MASHT-i së bashku me qeverinë janë fajtorë për krejt këtë që ka ndodhur. Tri ditë para

grevës u kam shkruar ministrit dhe kryetarit të sindikatës që të merren vesh, sepse humbësit do të jenë fëmijët. Për këtë fajin e bartin Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit sepse koeficientin e mësimdhënësve e kanë lënë si çështje të fundit dhe për këtë janë marrë vesh dy orë para seancës. Fajtor për krejt këtë është qeveria dhe dikush duhet të japë llogari, sepse edhe po të zëvendësohen orët nuk do të ketë efekt siç do të kishte po të mbahej mësimi i rregull. Për këtë rast do të duhej të jepnin dorëheqje ministri i Arsimit dhe kryeministri.

"Epoka e re": Nevojitet angazhim i kryeministrit për këtë çështje? Kurteshi: Kryeministri Haradinaj më mirë do të ishte sikur të angazhohej që të mos ndodhte greva fare. Edhe tash do të ishte mirë që të angazhohet dhe, nëse

e humbura gjatë grevës

ministri ka marrë vendim për kompensimin e orëve. SBASHK-u njëherë deklaroi se, nëse ministri tërheq vendimin, orët mund të zëvendësohen, pastaj shtoi se orët zëvendësohen një javë nëse rregullohet çështja e koeficientit të mësuesve të ciklit klasor. Që do të thotë se kërkesat e sindikatës nuk janë parimore, por mësuesit nuk kanë aspak faj sepse ata e kanë sindikatën, një organizatë të cilën e kanë zgjedhur vetë, i besojnë dhe i respektojnë qëndrimet e saj. Kurse MASHT-i dhe qeveria kanë bërë shumë gabime në këtë fushë. Ata nuk janë marrë në radhë të parë me mësimdhënësit në Ligjin për Paga. Edhe pse të gjithë kanë thënë se arsimit është prioritet, kur të vijë puna për të ndërmarrë diçka konkrete, arsimin e lënë të parafundit ose të fundit. Fajin kryesor e ka qeveria sepse krejt ligji ka filluar gabim. Njëherë ia kanë rritur pagat vetes, prokurorëve, të tjerëve dhe në fund i kanë lënë mësimdhënësit, për të cilët kanë thënë se nuk po kanë mjete.

"Epoka e re": Z. Kurteshi, drejtuesit e SBASHK-ut fillimisht thanë se duhet të pritët vendimi i gjykatës për zëvendësimin e orëve, kurse më pas dolën me kërkesë të re për plotësimndryshimin e Ligjit për Paga, përkatësisht për barazimin e koeficientit të mësimdhënëse të ciklit klasor me mësimdhënësit e ciklit më të lartë. Do të thotë, as sindikata nuk e ka mbajtur fjalën. Kurteshi: Po, kjo i bie që sindikata ka luajtur me qëndrimet e veta. Njëherë kërkon tërheqjen e vendimit, pastaj kërkon plotësimndryshimin e ligjit. Njëherë thotë po shkelen të drejtat e fëmijëve, pastaj thotë nëse plotësohen këto kërkesa i zëvendësojmë orët e humbura. Do të thotë, SBASHK-u nuk ka qenë konsistente në qëndrime dhe kjo nuk është në rregull.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh këtë qasje si dhe inatet ndërmjet SBASHK-ut dhe MASHT-it, ka rrezik që të ketë zvarritje të zgjidhjes së këtij problemi?

Kurteshi: Po të mos ishte humbja që po u shkaktohet fëmijëve nuk do të isha marrë aspak me këtë punë sepse, tekefundit, nuk është puna jonë ndërmjetësimi MASHT-SBASHK. Janë fëmijët ata që mua personalisht më bëjnë t'i lus SBASHK-un dhe MASHT-in që të merren vesh. Pres që te palët të mbizotërojnë arsyeja, t'i harrojnë inatet dhe të marrin vendim në interes të fëmijëve. MASHT-i ka gabimet e veta në këtë drejtim, madje ka humbur edhe autoritetin, sepse vendimi nuk është bazuar në ligj. SBASHK-u është në rregull sa i përket aspektit ligjor, por vendimi duhet të jetë në interes të fëmijëve.

Turqia konfirmon përkrahjen për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Rrustem Berisha, ka pritur të enjten në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes së Turqisë, Hulusi Akar, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet dy ministrive si dhe të dy ushtrive përkatëse, duke evidentuar mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejme edhe në të ardhmen. Në fund të takimit të dy ministrat, Berisha dhe Akar, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dy ministrive

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Rrustem Berisha, ka pritur në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, Hulusi Akar. Ministri i Mbrojtjes i Turqisë, Hulusi Akar, u prit me nderime të larta ushtarake nga Njësia Ceremoniale dhe Trupa Muzikore e FSK-së. Të dy ministrat, Berisha dhe Akar, së pari zhvilluan një takim të përbashkët, kokë me kokë. Më pas takimi vazhdoi në nivelin e zgjeruar të dy delegacioneve. Ministri i Mbrojtjes i Turqisë shoqërohej nga një ekip i gjerë bashkëpunëtorësh dhe zyrtarësh, kurse ministri Berisha shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama dhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, si dhe zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes. Në takimin e përbashkët të të dy delegacioneve u prezantuan arritjet e përgjithshme të FSK-së, procesi i transformimit dhe perspektiva e zhvillimit sipas

planeve të parapara. Po ashtu, u bë edhe prezantimi i bashkëpunimit të deritashëm në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Turqisë si dhe të dy ushtrive përkatëse, duke evidentuar mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejme edhe në të ardhmen. Në fund të takimit të dy ministrat, Berisha dhe Akar, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dy ministrive të mbrojtjes, në të cilën përfshihen fushat me interes të përbashkët të bashkëpunimit. Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim ministrin e Mbrojtjes së Turqisë, Hulusi Akar, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në vend dhe rajon si dhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy vendeve. Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar ministrin Akar për progresin e përgjithshëm në Kosovë, prioritetet e Qeverisë së Kosovës, agjendën e reformave evropiane, zhvillimin ekonomik, si dhe

orientimin euroatlantik të Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka falënderuar ministrin Akar dhe shtetin e Turqisë për ndihmën dhënë Kosovës në të gjitha periudhat, në të njëjtën kohë ka kërkuar mbështetjen edhe për proceset e tjera zhvillimore dhe rugën e integritetit euroatlantik. "Republika e Kosovës dhe Turqia kanë bashkëpunim të frytshëm dhe Kosova është e interesuar që edhe në të ardhmen ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në fushën e sigurisë dhe në atë të ekonomisë", ka thënë Haradinaj. Kryeministri Haradinaj e ka uruar ministrin Akar me rastin e 70-vjetorit të NATO-s, duke falënderuar për kontributin e personelit ushtarak e civil turk brenda KFOR-it për paqe dhe siguri në Kosovë. Ministri i Mbrojtjes së Turqisë, Hulusi Akar, ka vlerësuar progresin e Kosovës në të gjitha fushat, duke thënë se Turqia do ta vazhdojë mbështetjen e Republikës së Kosovës në fushën e sigurisë, ngritjen e kapaciteteve të FSK-së dhe integritetit euroatlantik të Kosovës.



ka mundësi, të riparohet diçka nga ajo që është dëmtuar. Përherë unë nisem nga ndjenja e një mësuesi sepse në parim jam mësues, prandaj jam jashtëzakonisht i brengosur për humbjet që po u shkaktohen fëmijëve.

"Epoka e re": Të qenit mësues po ndikon që ju t'ia mbani anën sindikatës dhe mësuesve dhe ta lini fajtorë ministrin dhe qeverinë?

Kurteshi: Jo. Mësuesit më së paku kanë faj sepse ata dhe nxënësit kanë mbetur pengë të mosmarrëveshjeve në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut. Mosmarrëveshjet në mes të këtyre dy palëve janë më tepër çështje inatësh. MASHT-i është inatosur që marrëveshja është nënshkruar me kryetarin e Kuvendit, gjë që nuk është dashur të ndodhë. Kurse SBASHK-u është inatosur që

Haradinaj: Mirëpresim kritikë nga shoqëria civile, por kjo qeveri nuk është qeveri që vajton

Me rastin e lansimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se mirëpret kritikë nga shoqëria civile por, sipas tij, kjo qeveri nuk është qeveri që vajton, por që përballet me të gjitha problemet e këtij vendi

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të enjten në lansimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023, organizuar nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të BE-së, që ka për qëllim prezantimin e synimeve të qeverisë para publikut, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve të institucioneve dhe partnerëve në përfshirje të zbatimit dhe monitorimit të strategjisë.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023 ndërlihet me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021 dhe ka për qëllim vazhdimin e

komunikimit të rregullt me shoqërinë civile dhe partnerë të tjerë. "Me këtë strategji ne synojmë që ta rrisim bashkëpunimin dhe t'i arrijmë katër objektivat strategjike: rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në bërjen e politikave, rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në financimin publik për shoqërinë civile, zhvillimin e praktikave dhe procedurave për kontraktimin e shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve publike dhe nxitjen dhe promovimin e vullnetarizimit në programet në interes publik", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se duhet të jemi krenarë ngaqë, sipas treguesit të Bankës Botërore për politikëbërje, Kosova është renditur e para në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të procesit të politikëbërjes në qeveri. Haradinaj ka thënë se për ta vazhduar këtë punë suksesshëm, në mbledhjen e fundit të qeverisë



është marrë vendimi për themelimin e këshillit për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile, i cili nuk do të ketë për mandat vetëm zbatimin e Strategjisë, por do të jetë mekanizmi kryesor i cili do ta koordinojë të gjithë procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka siguruar përkrahjen e tij dhe të qeverisë për mbështetje e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, me qëllim të zbatimit sa më efikas të Strategjisë. "Qeveria, po ashtu, ka zotuar dhe siguruar buxhetin për

objektivat, planin e veprimit dhe për zhvillimin e mirëfillt të punës për zbatimin e strategjisë", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke theksuar se, pavarësisht prej të arriturave, gjithmonë na mbetet shumë punë për të bërë, që këto objektiva të vendosura në këtë strategji të realizohen.

Haradinaj ka falënderuar donatorët, duke thënë se, përveç programit tonë, është një përfshirje e madhe e partnerëve, e donatorëve, e vendeve të BE-së, Amerikës, për përkrahjen që i kanë dhënë gjithë këto vite dhe vazhdojnë të japin për shoqërinë

civile në Kosovë.

Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë, ka vlerësuar se lansimi i strategjisë është një ditë e rëndësishme, duke thënë se strategjia është një zotim i rëndësishëm për një dialog gjithëpërfshirës në mes të qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit, Habit Hajredini, ka thënë se ky është një i dokument i rëndësishëm i përbashkët ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile, i cili synon forcimin e dialogut ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile.

Në Klinë shënohet Dita e të Pagjeturve



KLINË, 4 PRILL (ER) - "Një popull që harron njerëzit e vet të martirizuar është i dënuar t'i përsëritet historia, prandaj sot e përgjithmonë do t'i kujtojmë ata që u flijuan për këtë tokë. Liria e Kosovës mban emrin e secilit prej tyre", ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në akademinë përkujtimore në Ditën e të Zhdukurve të Komunës së Klinës.

Fillimisht kryeministri Haradinaj është prituri nga kryetari i komunës, Zenun Elezaj dhe ka bërë homazhe te lapidari i mar-

tirëve, ku janë të shënuar emrat e të pagjeturve të kësaj komune. Para të pranishmëve të shumtë, kryeministri Haradinaj ka thënë se Klina në luftë ka humbur shumë njerëz dhe secili prej tyre është një plagë e hapur në zemrat e familjarëve dhe dëshmi që përshkruan rrugën e vështirë që kaluam deri në liri. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka theksuar se institucionet e Kosovës nuk do të ndalen së kërkuari drejtësi, që udhëheqësit dhe ekzekutorët të sillen para drejtësisë, që të ndriçohet fati i të pagjeturve të luftës dhe që shteti të

kujdeset në mënyrë institucionale për familjet e martirëve dhe të pagjeturve duke rregulluar statusin e tyre me ligj.

Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka thënë se shënimi i ditës së të pagjeturve për Komunën e Klinës është plagë e cila vazhdon të rëndojë në shpirt-trat dhe mendjet e tyre si një prej dhembjeve më të thella që la lufta dhe gjenocidi serb në këtë komunë në periudhën e luftës së fundit.

Një fjalë para të pranishmëve në emër të familjarëve të dëshmorëve e mbajti Nexhmije Gashi.

Kryeshefi i Telekomit fillon vizitat nëpër regjione, nis me Gjilanin

GJILAN, 4 PRILL (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka filluar vizitat nëpër regjione, duke nisur me Gjilanin, ku ka parë së afërmi aktivitetet e punës që po bëhen në këtë pikë të shitjes. Istrefi të enjten është takuar me menaxherin rajonal të shitjes, Ilir Halilin dhe kolegët e tjerë të Telekomit të Kosovës në Gjilan, me të cilët ka diskutuar për ecurinë e shitjes së produkteve të reja në treg si dhe investimet në projekte të reja.

Produktet e reja, të cilat janë të shumta, e sidomos pakot e

fundit promovionale të kombinuara të telefonisë fikse, internetit dhe TV-së, janë të disponueshme për të gjithë konsumatorët me çmime tejet të ulëta, duke rritur numrin e përgjithshëm të konsumatorëve të rinj në vendbanime të ndryshme të territorit të Kosovës. "Jam këtu sot për ta inkurajuar secilin prej jush se me këtë përkushtim të treguar, për punët teknike që janë duke u kryer në terren si dhe me tërheqjen e bizneseve dhe institucioneve publike dhe arsimore të kësaj komune në

Vala, se Telekomit ka të ardhme dhe këto sfida do të tejkalohen", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi.

Gjatë diskutimit, Istrefi i ka siguruar të gjithë punonjësit në Gjilan se do të kenë përkrahjen e tij të plotë për t'u përballur me të gjitha problemet dhe vështirësitë që mund të kenë gjatë kryerjes së punëve të përditshme, me interes të përbashkët për kompaninë dhe për realizimin e strategjisë zhvillimore të Telekomit të Kosovës. Telekomit i Kosovës/Vala



vazhdimisht ka hedhur në treg produkte tejet atraktive, siç janë pakot familjare Prepaid, pakot e kombinuara FOL, pakot indi-

viduale Postpaid, pakot e internetit etj., duke targetuar kështu të gjitha grupmoshat e shoqërisë.

Fillon projekti i madh për ndërtimin e spitalit të Prishtinës

Të enjten është bërë hapi i parë drejt jetësimit të kërkesës së kamotshme të qytetarëve të Prishtinës për spitalin e kryeqytetit. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, së bashku me ministrin e Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, kanë nënshkruar memorandumun e mirëkuptimit për fillimin e ndërtimit të spitalit të Prishtinës

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, së bashku me ministrin e Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, kanë nënshkruar të enjten memorandumun e mirëkuptimit për fillimin e ndërtimit të spitalit të Prishtinës. Memorandumi i mirëkuptimit "Projekti dhe ndërtimi i spitalit të Prishtinës", që u nënshkrua nga të dy ministrat, përcakton obligimet institucionale për realizimin sa më të shpejtë dhe efikas të projektit.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, pas nënshkrimit të memorandumit, ka thënë se tani edhe zyrtarisht nis projekti i madh për ndërtimin e këtij spitali shumë të rëndësishëm për kryeqytetin. "Sapo e bëmë hapin e parë drejt jetësimit të kërkesës së kamotshme të qytetarëve të Prishtinës për spitalin e kryeqytetit. Me

nënshkrimin e marrëveshjes me ministrin Jagxhillar dhe me buxhet tanimë të ndarë po nisim projektimin dhe ndërtimin e spitalit të kryeqytetit tonë. Prioriteti ynë për shëndetësinë më afër qytetarit po ec përpara", ka thënë ministri Ismaili.

Ai ka theksuar se qytetarët e Prishtinës padrejtësisht që njëzet vjet janë privuar nga e drejta në shërbime shëndetësore në qytetin e tyre, kurse ndërtimi i spitalit tashmë nuk është më një premtim, por një projekt që po merr përgjegjësi konkrete me fillimin e realizimit të tij.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka thënë se spitali i Prishtinës do të jetë një projekt i rëndësishëm për shtetin e Kosovës, Ministrinë e Shëndetësisë, Komunën e Prishtinës dhe qytetarët e kryeqytetit, të cilët do të marrin shërbime cilësore në këtë spital që do të ndërtohet.

Në bazë të këtij memorandum, ministria e Shëndetësisë do t'i ofrojë të gjitha informatat, dokumentacionin dhe mbështetjen e saj që ky projekt të zhvillohet në mënyrë sa më efikase.



Projekti, sipas këtij memorandum, do të realizohet në katër faza: 1. Realizimi i studimit të nevojave dhe vlerësimit të kapaciteteve; 2. Themelimi i spitalit të përgjithshëm të kryeqytetit,

ashtu siç përcaktohet me Ligjin për kryeqytetin; 3. Hartimi i projektit detal për ndërtimin në bazë të studimit; 4. Ndërtimi i objektit në bazë të projektit detal si dhe mbikëqyrja profesionale e fazës së ndërtimit.

Për studimin e fizibilitetit Ministria e Administratës Publike ka ndarë 500 mijë euro, ku i njëjti pritet të përfundojë brenda disa muajve. Ndërkohë, për vitet 2019-2021, brenda së cilës periudhë pritet të përfundojë ndërtimi i këtij spitali, për realizimin e tij janë ndarë shtatë milionë euro.

Megjithatë, koston dhe kapacitetin e tij do të përcaktojë studimi i fizibilitetit që do të udhëhiqet nga Ministria e Administratës Publike.

Arrihet pajtim për hapat e Kosovës rreth projekteve si parakusht për marrjen e fondeve të BE-së

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Në Prishtinë është mbajtur të enjten takimi i radhës në mes të Komisionit Evropian (KE), Zyrës së BE-së në Kosovë, Ministrisë së Integritimit Evropian dhe institucioneve të tjera të lidhura me procesin integruar.

Në takim mori pjesë David Cullen nga KE-ja, ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, dhe personalitete të tjera, me ç'rast shqyrtuan zbatimin e asistencës së BE-së nëpërmjet instrumentit të paraanëtarësimit, IPA, çështjet e ndërlidhura me IPA dhe progresin për këtë çështje gjatë vitit 2018. "Duhet të dëshmojmë se kemi stabilitet makroekonomik, emërimin e Komisionarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, deponia e mbeturinave të rrezikshme, salla e koncerteve dhe transferi-

mi i inspektorëve komunalë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, janë disa nga parakushtet për fondet e BE-së. Mospërmbushja e parakushteve për zbatimin e projekteve mund të rezultojë me anulimin e tyre ose me shtyrjen apo zëvendësimin me projekte të tjera. Anulimi i ndihmës nga BE-ja është e papranueshme andaj duhet që sot t'i ofrojmë përgjigjet e duhura dhe t'i identifikojmë hapat e radhës për ta mundësuar zgjidhjen e këtyre problemeve", ka potencuar ministrja Hoxha.

Ministrja Hoxha më pas i ka ftuar përfaqësuesit e institucioneve të raportojnë shkurt rreth gjendjes në sektorët e tyre, njëkohësisht ta ofrojnë zgjidhjen e sfidave në sektorët e tyre. Pas debatit dhe shqyrtimit të çështjeve një nga një, u arrit pajtim për hapat e radhës ndërmjet Kosovës dhe përfaqësuesve të KE-së. U ofruan zgjidhjet për të gjitha çështjet e ngritura ngaqë, siç potencoi ministrja Hoxha, qeveria nuk do ta lejojë humbjen e fondeve për shkaqe të paarsyeshme.



Prokurorisë për keqpërdorim të detyrës zyrtare ndaj zyrtarëve në fjalë. Gjatë aktgjykimit të shpallur kryetari i trupit gjykues,

Zyhdi Haziri, ka deklaruar se nuk është vërtetuar se dy të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën akuzoheshin.

Shpallen të pafajshëm dy drejtorët e Komunës së Gjilanit

GJILAN, 4 PRILL (ER) - Gjykata Themelore në Gjilan e ka shpallur të pafajshëm drejtorin aktual të Shërbimeve Publike në

Komunën e Gjilanit, Naser Korça, dhe ish-drejtorin e Urbanizimit, Valon Shefkiu, të cilët akuzoheshin për keqpërdorim të

detyrës zyrtare. Pas procesit maratonik gjyqësor të filluar një vit më parë, Gjykata Themelore ka hedhur poshtë pretendimet e

Prokurorisë për keqpërdorim të detyrës zyrtare ndaj zyrtarëve në fjalë. Gjatë aktgjykimit të shpallur kryetari i trupit gjykues,

Zyhdi Haziri, ka deklaruar se nuk është vërtetuar se dy të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën akuzoheshin.

Serbia nuk ka bazë për ta dërguar Kosovën në arbitrazh!



Shkruan: Endrit SHALA

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vendosjen e masës 100 për qind për të gjitha produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina është marrë duke u bazuar në faktin se marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare në mes të Republikës së Kosovës dhe këtyre dy shteteve kanë qenë dhe janë thellësisht asimetrike, situatë kjo e cila vetëm sa ka evoluar për shkak të problemeve politike të shkaktuara nga këto dy vende e të cilat kanë ndikuar seriozisht

dhe e kanë dëmtuar Republikën e Kosovës dhe ekonominë e saj. Këto dy vende në mënyrë konstante kanë vendosur barriera të pajustificueshme ndaj tregtisë dhe ekonomisë së Kosovës në kundërshtim me objektivat e Marrëveshjes së CEFTA-s, respektivisht neni 1 dhe neni 13 mbi barrierat teknike në tregti. Republika e Kosovës si shtet anëtar i marrëveshjes së CEFTA-s është e obliguar që të raportojë të gjitha barrierat tarifore dhe jotarifore të vendosura nga vendet anëtare të kësaj organizate. Ne vazhdimisht kemi raportuar këto barriera, dhe duke qenë se nuk ka pasur asnjë reagim nga vendet e CEFTA-s, unë kam propozuar për vendosjen e masës 100 për qind më 6 nëntor 2018, masë e cila pastaj me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës është shndërruar në 100 për qind më 22 nëntor të vitit 2018.

Shtetet anëtare të CEFTA duke u bazuar në nenin 42 paragrafi 2 i kësaj marrëveshje kanë të drejtë të kërkojnë konsultime bilaterale kur ka probleme të tilla. Unë kam pranuar dy kërkesa të tilla nga Ministri respektiv të Serbisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës dhe asnjëra nga këto kërkesa nuk i janë adresuar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë nuk kam pranuar takime bilaterale në emër të Republikës së Kosovës, pasi kërkesat kanë qenë të adresuara për dikë tjetër, për UNMIK-un. Me datë 7 dhjetor 2018 unë u jam përgjigjur të dy ministrave të të dyja vendeve se kërkesat e tilla janë të drejtuara në adresë të gabuar dhe nëse këto kërkesa nuk adresohen në adresën e duhur, d.m.th Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës, atëherë nuk do të fillojë numërimi i ditëve për konsul-

time, siç e kërkon paragrafi 42 i marrëveshjes së CEFTA. Me datë 11 dhjetor 2018 unë kam pranuar kërkesë për konsultime bilaterale nga Bosnja dhe Hercegovina, kërkesë kjo e cila ka qenë e adresuar duke u bazuar në marrëveshjet e arritura në Bruksel në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Si rrjedhojë, me datë 24.01.2019 unë kam autorizuar një delegacion të MTI-së që të udhëtojë në Bosnje dhe Hercegovinë për të përmbushur kërkesën e përmendur më lartë në përputhje me nenin 42 paragrafi 2 të CEFTA. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka pranuar asnjëherë asnjë kërkesë zyrtare nga Serbia adresuar Republikës së Kosovës apo institucioneve të saj, dhe si rrjedhojë e mungesës së kërkesës nga ana e Serbisë drejtuar institucioneve të saj, neni 42 paragrafi 2 i marrëveshjes së CEFTA-s nuk

mund të zbatohet. Duke u bazuar në faktet e përmendura më lartë dhe duke marrë shkas nga raportimet e mediave sot se kryeministrja e Serbisë paralajmëron dërgimin e Kosovës në Gjykatën e Arbitrazhit për vendosjen e masës 100 për qind, qëndrimi zyrtar i MTI është se ky veprim nuk mund të bëhet nga ana e Serbisë pasi që nuk është përmbushur neni 42 paragrafi 2 i marrëveshjes së CEFTA-s. Njëkohësisht me një veprim të tillë, ku Serbia do të tentonte ta dërgoj Kosovën në Gjykatën e Arbitrazhit do të nënkuptonte se në një mënyrë Serbia do ta njëjto Republikën e Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nuk e konsideron problematike të ketë konsultime bilaterale, në nivel të barabartë si dy shtete anëtare të CEFTA-s, nëse kërkesa do të bëhej në mënyrë të duhur nga Serbia.

Bruto Produkti Vendor shënoi rritje në Kosovë

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK-së), "Bruto Produkti Vendor" (BPV) për tremujorin e katërt (TM4) 2018 ka shënuar rritje reale për 3.8 për qind në krahasim me TM4 të vitit 2017

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 PRILL - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportin për "Bruto Produktin Vendor" (BPV) për tremujorin e katërt (TM4) 2018, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante. Sipas ASK-së, BPV-ja në TM4 të vitit 2018 shënon rritje reale për

3.8 për qind në krahasim me TM4 të vitit 2017. "Rritja reale e BPV-së, sipas aktiviteteve ekonomike, është si vijon: aktivitetet financiare dhe të sigurimit 32.2 për qind; furnizimi me energji elektrike, ujë dhe trajtimi i mbeturinave 11.2 për qind; ndërtimtaria 6.5 për qind; tregtia me shumicë dhe pakicë 6.1 për qind; industria përpunuese 5 për qind; hotelet dhe restorantet me 4.8 për qind;



bujqësia, gjuetia, pylltaria 1.7 për qind; afarizmi me pasuri të patundshme 1.4 për qind; trans-

porti dhe magazinimi 1 për qind", thuhet në raportin e ASK-së. Rënie reale kishte në të dhënat e

industrisë nxjerrëse (-15.3 për qind) dhe administrimit publik (-0.1 për qind). Kurse BPV-ja, sipas qasjes së shpenzimeve, ka pasur rritje në: formimin e bruto kapitalit me 9.2 për qind; eksportin e mallrave dhe shërbimeve me 7.2 për qind; importin e mallrave dhe shërbimeve me 4.4 për qind; shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe institucioneve jopërfutuese në shërbim të ekonomive shtëpiake (IPShESH) me 2.3 për qind; shpenzimet e konsumit final të Qeverisë me 1.1 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në Prizren diskutohet për ngritjen e sigurisë në shkolla dhe në komunikacionin rrugor

Prizren, 4 prill (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në qytetin e Prizrenit ka mbajtur të enjten mbledhjen e radhës, ku të pranishëm ishin edhe ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa dhe kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka. Ministri Mustafa ka folur rreth sigurisë së përgjithshme, ngritjes së sigurisë në shkolla dhe sigurisë në komunikacionin rrugor. Gjatë debatit fjalën e mori edhe kryetari i komunës, Mytaher Haskuka, i cili tha se komuna vitin e kaluar ka shtuar ndriçimin publik në rrugë deri në 15 kilometra gjatësi dhe do të vazhdojë

edhe sivjet që ta bëjë ndriçimin e rrugëve, qoftë me shtimin e shtyllave të reja të ndriçimit publik apo riparimit të atyre ekzistuese. Sa iu përket zjarrvënies nëpër pyje, kryetari Haskuka ka thënë se në Prizren janë identifikuar rreth 200 raste të zjarrvënies por që, sipas tij, fatmirësisht, për shkak të temperaturave jo shumë të larta, ato nuk janë përhapur në sipërfaqe më të mëdha. Në lidhje me këtë, Haskuka ka ftuar organet e drejtësisë që të ketë masa më të rrepta ndëshkuese ndaj atyre që shkaktojnë dëme të tilla.

Kurse rreth pyetjes për qentë endacakë, kryetari edhe një herë ka bërë me dije se trajtimi i tyre vazhdon të bëhet në bashkëpunim me Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit, derisa procesi i ndërtimit të Qendrës për Trajtimin e Qenve ka ngecur paksa për shkak të çështjeve pronësore me Agjencinë e Pyjeve. Gjithashtu, në lidhje me trajtimin e qenve endacakë, Haskuka ka theksuar se Komuna e Prizrenit ka bashkëpunim me organizata të ndryshme joqeveritare që merren me mbrojtjen e kafshëve. Kryetari Haskuka ka kërkuar nga



ministri i Punëve të Brendshme që të miratohet sa më shpejt Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve nga ana e Qeverisë, në mënyrë që të

ketë mekanizma shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve në rrugë dhe me anë të këtij ligji të evitohet edhe problemi i lypsarëve.

Vendet e Ballkanit Perëndimor nënshkruajnë marrëveshje për heqjen e tarifave roaming

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia, kanë nënshkruar marrëveshjen për heqjen e tarifave roaming në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Implementimi i kësaj marrëveshje fillon më 1 korrik të këtij viti, duke zvogëluar shumëfish tarifën deri më 1 korrik të 2021-s, ku bëhet eliminimi i tërësishëm sipas konceptit 'Roam Like At Home'



ndërmjet vete. "Kjo agjendë digjitale po na ndihmon të integrohem, edhe pse nuk jemi pjesë e Bashkimit Evropian. Sfidat janë kryesore të integritetit digjital. Kjo marrëveshje që do të nënshkruhet sot është mundësi që t'i trajtojë njëjtë qytetarët e Ballkanit Perëndimor dhe t'i lidhë bizneset ndërmjet vete. Më shumë se 12 milionë turistë që vitin e kaluar shijuan dhe u endën mes mrekullive të Ballkanit u kthyen pas në vendet e tyre duke rrudhur buzët për faturat e roamingut, edhe më të kripura se uji i detit. Të ndryshëm, por të ngjashëm, të gjithë janë në një mendje, se ulja dhe heqja e tarifave të roamingut iu vjen për shtat të gjithëve dhe ndihmon në zhvillimin e

ekonomisë", u shpreh Bregu, duke shtuar se kjo marrëveshje do të ketë ndikim ekonomik, politik dhe social. "Për t'i thënë gjërat troç, Ballkani Perëndimor nuk është një rajon i zhvilluar ekonomikisht. Papunësia është e lartë, largimi i 'trurit' po rritet, të rinjtë duan të ikin. Njerëzit humbasin vendin e punës për arsye të ndryshme, por për disa të tjerë ky hov i teknologjisë është një rrezik edhe më i madh. Jetojmë në një botë që s'po u lë më thuajse hapësirë atyre që s'përshtaten dot me teknologjinë. Je apo s'je online është çështja. Lidhjet shoqërore, ndjenjat, aktivitetet, aventurat, biznesi, politikat, qeveritë, gjithçka po kalon online", ka thënë Bregu.

Një vit më parë, në Sofje, në Samitin për Ballkanin Perëndimor - BE, u vendos nisma për një marrëveshje rajonale roaming falas për rajonin. Më 30 maj të vitit të kaluar deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë shqyrtuar një rezolutë të propozuar nga deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj, e cila kishte për qëllim ta heqë roamingun me Shqipërinë. Në prezantimin e rezolutës, deputeti Molliqaj pati deklaruar një milion thirrje pranojnë qytetarët e Kosovës nga Shqipëria dhe anasjelltas. Rezolutën e propozuar nga deputeti Molliqaj e patën përkrahur të gjitha grupet parlamentare, duke e vlerësuar si të domosdoshëm heqjen e roamingut mes dy vendeve.

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 PRILL - Në samitin digjital të Ballkanit Perëndimor, i cili po mbahet në Beograd, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljuka, në emër të Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen për zbritjen e çmimeve të roamingut për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Palët nënshkruese të marrëveshjes, e cila do të quhet "Roaming si në shtëpi", do të fillojnë gradualisht që nga 1 korriku i këtij viti t'i ulin kostot e roamingut, ndërsa nga 1 korriku i vitit 2021 nuk do të ketë çmime bazë të roamingut. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia. Ministri Ljuka ka folur për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Ai ka thënë se ky do të jetë një hap i mëtutjeshëm për interkonektivitet ndërmjet vendeve të Ballkanit. "Është një lajm shumë i mirë për vendet e Ballkanit

Perëndimor arritja e një marrëveshjeje të tillë. Besoj se kjo marrëveshje është edhe një hap më tutje drejt rritjes së bashkëpunimit rajonal mes shteteve të Ballkanit Perëndimor", është shprehur ministri Ljuka.

Komisionarja evropiane për ekonomi dhe shoqëri digjitale, Mariya Gabriel, ka thënë se Bashkimi Evropian do ta përkrahë këtë marrëveshje për digjitalizimin e Ballkanit. "Kjo është marrëveshja juaj. Ne si BE do t'ju përkrahim. Ju mund të llogarisni te mbështetja jonë dhe kjo është një ditë historike që duhet punuar në këtë drejtim. Agjenda evropiane digjitale nuk është vetëm një deklaratë, por më shumë se kaq. BE-ja ka ndarë mbi 30 milionë euro për këtë aspekt, përkatesisht për digjitalizimin e Ballkanit", ka deklaruar komisionerja Gabriel.

Ndërsa Majlinda Bregu, sekretare e përgjithshme e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, ka deklaruar se kjo marrëveshje është mundësi e mirë që, ndër të tjera, të lidhen edhe bizneset

Banka Botërore demanton lajmin se janë humbur 17 000 vende të punës



PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Zyra e Bankës Botërore përmes një deklaratë për media ka qartësuar se raporti i Rregullt Ekonomik (RER) për ekonominë e Ballkanit Perëndimor, i publikuar para pak kohe, nuk konkludon se 17 000 vende të punës janë humbur në vitin 2018, siç është raportuar në disa media. Bazuar në anketën tremujorëshe të fuqisë punëtore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (të publikuar më 19 mars, 2019),

RER raporton një rënie të shkallës (vjetore) së papunësisë prej rreth 1 pikë përqindje. Ky është numri i të papunësuarve si përqindje e fuqisë punëtore aktive totale.

Në të njëjtën kohë ka pasur një rënie të numrit të njerëzve që kanë marrë pjesë në tregun e punës. Bazuar në të dhënat nga anketa e njëjtë e fuqisë punëtore, RER komenton se krijimi i vendeve të punës neto në periudhën korrik-dhjetor 2018 ende

nuk kishte kompensuar plotësisht humbjet e vendeve të punës neto në dy çerekët e parë të vitit.

Kjo ka çuar në një rënie të vlerësuar të shkallës së punësisë (që është numri i të punësuarve si përqindje e popullsisë në moshë pune) prej 1 pikë përqindje në çerekun e katërt të vitit 2018 në krahasim me çerekun e njëjtë në 2017, një diferencë prej 7900 vendeve të punës, sipas anketës së fuqisë punëtore.

Komuna e Prishtinës pret të marrë tokë nga KRU 'Prishtina' te 'Fusha e Pajtitit'

Prishtinë, 4 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se toka e Kompanisë Rajonale të Ujësllësit (KRU) 'Prishtina', te 'Fusha e Pajtitit', është shumë afër të kalojë në pronësi të kësaj komune. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se vitin e kaluar e kanë bërë këtë kërkesë

pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe KRU 'Prishtinës'. "Kemi pasur edhe shumë takime. Këto ditë Bordi i KRU 'Prishtinës' e ka aprovuar këtë kërkesë. Tash çështja do të kalojë pranë Komitetit Ndërmarrje për Ndërmarrje Publike për aprovim e pastaj tek Qeveria e Kosovës. Shpresoj që

këto dyja ta aprovojnë këtë kërkesë. Arsyeja është e thjeshtë. Kjo tokë ka kapacitet të absorbojë një çerdhe apo shkollë, një park dhe një fushë sportive", ka shkruar Ahmeti, duke shtuar se banorët e banesave sociale te 'Fusha e Pajtitit' do të kenë qasje të menjëhershme te kjo infrastrukturë e re.



Aforizma për diplomatin dhe politikanin (IV)



Prof. Lisen BASHKURTI

- Njeriu që ndërhyt midis dy vetave dhe mbështet më të fortin ka prirje për pushtet, pra për politikan. Njeriu që ndërhyt midis dy vetave dhe mbështet më të dobëtin ka prirje për bamirësi, pra për misionar. Njeriu që ndërhyt midis dy vetave dhe tenton të dobësojë të fortin dhe të fuqizojë të dobëtin ka prirje për balancim, pra për diplomat.

- Diplomati është mjeshtër i negociimit, negociatori është mjeshtër i dialogut, dialoguesi është mjeshtër i bisedimeve, biseduesi është mjeshtër i oratorisë, oratori është mjeshtër i fjalës, fjala është mjeshtëria e diplomatit.

- Diplomati përdor tri mjete komunikimi: fjalën, emocionin dhe gjuhën trupore. Nga mënyra se si këto tri mjete komunikimi artikulohehen dhe kombinohen gjatë negociatave diplomatike varet në masë të konsiderueshme suksesi i diplomatit.

- Tri mjetet e komunikimit të diplomatit - fjala, emocionin dhe gjuha trupore, varësisht nga situata - mund të jenë në simetri, në asimetri ose në kundërshtitë ndërmjet tyre, me qëllim që t'i japin kundërshtarit mesazhe unike, diverse, kontradiktore ose konfuze.

- Mjeshtëria e përdorimit të simetrisë, asimetrisë dhe kundërshtisë ndërmjet fjalës, emocionit dhe gjuhës trupore, është pjesë e taktikës së negociimit diplomatik nga e cila varet shumë suksesi i

negociatave diplomatike.

- Misioni i diplomatit është që të përafrojë sa më shumë në kohë dhe në realitet identitetin objektiv të kombit të vet me imazhin subjektiv të perceptimeve ndërkombëtare rreth tij.

- Përafrimi i identitetit objektiv kombëtar me perceptimet subjektive ndërkombëtare synon ngritjen e reputacionit ndërkombëtar të identitetit kombëtar.

- Diplomati është mjeshtër i marketingut ndërkombëtar i identitetit kombëtar, duke thënë me zë të lartë të vërtetat e ndritura dhe duke thënë me zë të ulët të vërtetat e hidhura.

- Diferencat midis të vërtetave të ndritura identitare dhe të vërtetave të hidhura perceptimore mbushen nga mjeshtëria e diplomatit, e cila lypet ta mënjanojë njëkohësisht si bumerangun ashtu edhe propagandën, sepse bumerangu është vetëvrasje kombëtare, ndërsa propaganda është mashtrim ndërkombëtar. Të dyja prodhojnë reputacion të ulët ndërkombëtar.

- Diplomati ekziston dhe punon midis dy gjendjeve të kombit të vet: gjendjes së identitetit kombëtar dhe gjendjes së imazhit ndërkombëtar. E ndërsa politikanin merret kryesisht me gjendjen e identitetit kombëtar, diplomati merret kryesisht me gjendjen e imazhit ndërkombëtar.

- Politikani merret kryesisht me transformimin e realiteteve objektive kombëtare, diplomati merret kryesisht me perceptimet subjektive ndërkombëtare mbi këto realitete.

- Realitetet objektive kombëtare ndryshojnë më shpejt, stereotipat subjektive të perceptimeve ndërkombëtare ndryshojnë më ngadalë. Diplomati tenton të

lëvizë midis këtyre dy shpejtësive, duke synuar t'i afrojë ato sa më shumë.

- Diplomati dhe politikanin janë pjesë e establishmentit të politikave publike, por me funksione të veçanta dhe në hapësira të ndryshme. Në mjaft raste diplomati përprijet që të korrigojë me mjete diplomatike dhe në mjediset ndërkombëtare dështimet e politikave në nivele kombëtare.

- Diplomati është profesioni i zbulimit të dobësisë brenda fuqive dhe i fuqisë brenda dobësisë.

- Diplomati i mirë nuk dashurohet me vetveten dhe nuk urren kundërshtarin, përkundrazi ai qorton vetveten dhe vlerëson kundërshtarin.

- Për diplomatin e zot dashuria dhe urrejtja janë ndjenja të palexueshme dhe shpeshherë të konvertueshme me njëra-tjetrën.

- Midis dy palëve të kundërta në negociatë, diplomati dyzohet me qëllim që t'i fshehë qëllimet e veta dhe t'i zbulojë qëllimet e kundërshtarit.

- Prapa çdo humbje diplomatit lexon fitoren dhe prapa çdo fitoreje diplomatit lexon humbjen, sepse ai e fshin kufirin midis fitores dhe humbjes për t'i shmangur pakënaqësitë e palëve dhe për t'i bërë ato ta pranojnë rezultatit.

- Triumfi diplomatik është fitore pa të humbur, ndërsa dështimi i diplomatik është humbje pa të fituar.

- Me mjeshtërinë e kompromisit diplomatit shpesh fiton urrejtjen e më të fuqishmit dhe admirimin e më të dobëtit. Me këtë identitet, diplomati bëhet simbiozë e shkrirjes midis urrejtjes dhe admirimit.

- Mjeshtëria diplomatike prodhon fitore pa të humbur bazuar në

kompromis, ndërsa politika prodhon humbje pa të fituar bazuar në interesa.

- Politikani dhe diplomati ndryshojnë midis tyre në qasjen ndaj të vërtetave, sepse politikanin më së shumti rrëfen të vërtetat për të përfituar prej tyre, ndërsa diplomati më së shumti rrëfen të vërtetat për t'i mbrojtur ato nga gënjeshttrat.

- Politikani dhe diplomati ndryshojnë midis tyre edhe në qasjen ndaj gënjeshttrave, sepse politikanin më së shumti gënjen për t'i fshehur dështimet e tij, pra për interesa të pushtetit të vet, ndërsa diplomati më së shumti gënjen për t'i fshehur dobësitë e vendit të tij, pra për interesa të kombit të vet.

- Metaforikisht politikanin është rrobaqepësi që qepë kostumin për t'i vënë në dukje bukuritë e politikës së vet, ndërsa diplomati është rrobaqepësi që qepë kostumin për t'i fshehur gungat e kombit të vet.

- Politikani i mirë thotë 'jo' edhe kur duhet thënë 'po', ndërsa diplomati i mirë thotë 'po' edhe kur duhet thënë 'jo'.

- Për politikanin dera është bërë për t'u mbyllur, ndërsa për diplomatin dera është bërë për t'u hapur.

- Politikani edhe qimen e bën tra për hir të interesit, ndërsa diplomati edhe traun e bën qime për hir të kompromisit.

- Politika është hekur i skuqur që del nga zjari, ndërsa diplomacia është uji i ftohtë që e kalit atë.

- Edhe kur palët politike kundërshtare ngrënë muret e armiqësisë dhe luftojnë, diplomatët shtrojnë lëndinat e miqësisë dhe i paqëtojnë.

- Dashuria e fshehur dhe simpatia e shtirur janë veçori të sjelljeve të preferuara të diplomatit.

- Buzëqeshja e përhershme e diplomatit është arti për ta fshehur politikën e skërmitjes së dhëmbëve.

- Një komb i fuqishëm pa aftësi diplomatike është si elefanti në dyqanin e qelqurinave.

- Një diplomaci e aftë pa fuqi kombëtare është si njeriu me oreks të madh, por pa dhëmbë.

- Diplomati nuk është mjeshtër i përdorimit të fuqisë, por mjeshtër i mënjanimin të dobësisë.

- Në jo pak raste diplomacia është arti i të vërtetave të pathëna.

- Mbas shtrëngimit diplomatik të duarve bëj gjithnjë kujdes ta kontrollosh numrin e gishtave.

- Nëse i beson një diplomatit të zot zgjidhjen e problemeve të tua dije se nuk do të fitosh gjithçka, por ama të jesh i sigurt se nuk do të humbasësh çdo gjë.

- Në pikun e luftës diplomatit parandien ëndrën e paqes, ndërsa në pikun e paqes diplomatit parandien makthin e luftës.

- Mënyra e ekzistencës së diplomacisë është negociata e përhershme. Kur negociata ndërpritet, diplomacia vdes. Kur diplomacia vdes, lufta ngjallet.

- Për diplomatin është më mirë të mos i fillojë negociatat sesa t'i fillojë dhe t'i ndërpresë ato, sepse ndërprerja e negociatave diplomatike rrënon besimin midis palëve, që është gjysma e suksesit të negociatave.

- Gjuha e shprehjes së diplomatit është shumëkuptimëshe, sepse diplomati i shkruan mendimet në të dyja anët e fletëve, me qëllim që secila palë në konflikt ta gjejë vetveten. Mirëpo në jo pak raste palët në konflikt lexojnë atë faqe që i pëlqen dhe mënjanojnë atë tjetrën që nuk i pëlqen. E për këtë gabim të palëve në konflikt zakonisht fajësohen diplomatët.

Qeveria ka mundur të përfitojë më shumë nga projekti për zhvillimin e politikave

Procesi i zhvillimit të politikave ka një ndikim të gjerë dhe me interes për reformat në administratën publike të vendit. Falë mbështetjes nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), Qeveria e Kosovës ka zhvilluar mekanizma që ta përmirësojë këtë proces në fushën e legjislacionit dhe hartimit të politikave

EPOKA E RE


Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 PRILL - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës për projektin "Zhvillimi i kapaciteteve në procesin e bërjes së politikave dhe koordinimit në Kosovë", i cili është financuar nga SIDA dhe zbatuar nga Zyra e Kryeministrit (ZKM).

Qëllimi i këtij auditimi ishte të vlerësohet performanca e projektit. Auditimi ka nxjerrë përfundimin se projekti në përgjithësi ka arritur rezultate të rëndësishme duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e

politikave brenda qeverisë, duke futur mekanizma për kryerjen e analizave të politikave, analizën e ndikimit dhe mekanizmat mbështetës për përfshirjen efektive të shoqërisë civile. Pavarësisht prej kësaj, ekziston rreziku që pas përfundimit të projektit qeveria nuk do të ketë në dispozicion kapacitete të mjaftueshme për t'i kryer analizat e nevojshme të ndikimit ekonomik, planifikimit strategjik dhe komponentëve të tjerë të procesit për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit. Raporti thekson se mungesa e një procesi të rregullt të komunikimit interaktiv nga ekspertët afatgjatë të projektit me të gjithë përfituesit e synuar, ministrinë e linjës dhe

departamentet e ZKM-së mund të krijojë vështirësi për identifikimin e qartë të nevojave të tyre zhvillimore dhe për plotësimin e këtyre mangësive. Kjo mund të reflektojë me humbjen e mundësisë për përfitim nga ndihma e ekspertëve të SIDA-së. Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, lidhur me këtë auditim ka deklaruar se ka fusha ku projekti ka kontribuar fuqishëm në zhvillimin e qëndrueshëm në procesin e hartimit të politikave duke hartuar udhëzime dhe doracakë praktikë që janë vlerësuar pozitivisht nga përfituesit e projektit. "Megjithatë, përkundër progresit të bërë nga projekti në procesin e zhvillimit të politikave, disa mangësi të identi-



fikuara mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit dhe në këtë drejtim efektivitetin e procesit të zhvillimit të politikave", ka thënë Osmani. Bazuar në gjetjet e raportit, autoritetet përgjegjëse, respektivisht Zyra e Kryeministrit dhe projekti Sida, t'i shtojnë përpjekjet e tyre për t'i përmirësuar metodologjitë e përdorura për

ngritjen e kapaciteteve, rrisin komunikimin me përfituesit e synuar dhe ta monitorojë në mënyrë të vazhdueshme arritjen e rezultateve. Përmes kësaj procesi do të ketë ndikim më të madh në reformat e administratës publike si një nga elementët e rëndësishëm që korrespondon me aspiratën e vendit drejt integritimit në BE.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Hajdari: Të dielën do të ketë festë në 'Fadil Vokrri'

Lojtari i Gjilanit, Fiton Hajdari, është shumë i lumtur që derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Gjilanit dhe Dritës do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". "Është mirë që kjo ndeshje do të zhvillohet në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë. Aty janë të gjitha kushtet që të dyja skuadrat të aplikojnë lojërat e tyre, por edhe shikuesit mund të vijnë nga e gjithë Kosova për të parë një nga derbit më të zjarrtë në Ballkan. Nuk dyshoj se atmosfera do të jetë shumë e mirë, pasi gjithmonë 'Skifterat' dhe 'Intelektualët' kanë krijuar atmosfera të jashtëzakonshme", ka thënë Hajdari

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 PRILL - Futbollisti Fiton Hajdari i është gëzuar vendimit të Federatës së Futbollit të Kosovës që derbi Gjilani - Drita të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kjo ndeshje do të zhvillohet të dielën nga orën 20:00 dhe, sipas Hajdarit, qytetarët nga të gjitha pjesët e Kosovës mund të vijnë për ta përcjellë nga afër këtë derbi. "Është mirë që kjo ndeshje do të zhvillohet në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë. Aty janë të gjitha kushtet që të dyja skuadrat të aplikojnë lojërat e tyre, por edhe shikuesit mund të vijnë nga e gjithë Kosova për të parë një nga derbit më të zjarrtë në Ballkan. Nuk dyshoj se atmosfera do të jetë shumë e mirë, pasi gjithmonë 'Skifterat' dhe 'Intelektualët' kanë krijuar atmosfera të jashtëzakonshme", ka thënë Hajdari për "Epokën e re".

Në ndeshjen e fundit Gjilani luajti baras (0-0) në Skenderaj ndaj Drenicës, kurse tash synon të marrë një rezultat pozitiv në derbin ndaj Dritës. Kjo e fundit është kampione në fuqi, por e ka humbur hapin për ta mbrojtur titullin dhe është eliminuar nga Kupa, kurse Gjilani synim e ka ikjen nga zona e barazhit. "Ne kemi nevojë të madhe për pikë dhe jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje. Besoj se mund të marrin rezultat pozitiv, pse jo edhe fitore. Mungesa e vetme për ne ndaj Dritës do të jetë kapiteni Ylber Kastrati", ka deklaruar Hajdari.

Javë më parë skuadra e Gjilanit në pozitën e trajnerit e ka angazhuar strategun nga Shqipëria, Gentjan Mezani. Lidhur me këtë ndryshim Hajdari ka shtuar: "Trajneri i ri e ka sjellë një frymë të re në skuadër dhe jemi duke punuar shumë mirë me të, duke studiuar edhe hollësitë më të



vogla. Kemi filluar, po ashtu, t'i eliminonjmë edhe gabimet që kemi bërë në ndeshjet e kaluara". Gjilani aktualisht

pozicionohet në pozitën e gjashtë me 24 pikë, kurse Drita është dy pozita më lart me dhjetë pikë më shumë.

Autogoli i Jasharit ia sjell fitoren Feronikelit

Feronikeli me mund të madh e ka fituar ndeshjen ndaj Ballkanit me rezultat 1-0. Pas barazimit ndaj Flamurtarit në xhiron e kaluar në "Fadil Vokrri", skuadra lidere e kishte të vështirë për të arritur deri te trepikëshi ndaj Ballkanit. Dominimin Feronikeli e pati nga fillimi i ndeshjes e deri në fund, por fitoren kësaj skuadre ia siguroi mbrojtësi Dardan Jashari, i cili realizoi në portën e skuadrës së tij. Në ndeshjen e radhës, Feronikeli i shkon të hënën Lirisë në Prizren, kurse Ballkani të dielën e pret Flamurtarin.

SHKURT

Distria Krasniqi prezanton Kosovën në Turqi

Distria Krasniqi sot (e premte) do të garojë në Grand Prixin e xhudos që mbahet në Antalia të Turqisë. Distria është xhudistja e vetme që përfaqëson Kosovën në Antalia, kurse garon në kategorinë -48 kilogramë, në të cilën vitin e kaluar medaljen e argjendtë e kishte fituar Fjolla Kelmendi. Krasniqi vitin e kaluar e kishte fituar të artën në kategorinë -52 kg. Grand Prix Antalia 2019 vlen për pikë olimpikë "Tokio 2020".

Trajneri i Bremenit lavdëron Rashicën

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, ka qenë lojtari i ndeshjes në përballjen Schalke-Werder Bremen. Trajneri Florian Kohfeldt e ka lavdëruar yllin e Kosovës, i cili realizoi një gol shumë të bukur ndaj Schalkes. "Atë çfarë bëri Miloti mund ta bëjë përsëri. Ai e ka bërë një hap gjigant përpara. Ai ka më shumë besim në vetveten dhe mund t'i bëjë thjesht gjërat e tilla", ka thënë trajneri Kohfeldt.

Pingpongut i mundësohet një vend në Lojërat Evropiane 'Minsk 2019'

Federatës së Pingpongut të Kosovës i është mundësuar pjesëmarrja e një garuesi në Lojërat e Dytë Evropiane "Minsk 2019", të cilat mbahen prej 21-30 qershorit në Minsk të Bjellorusisë. Ftesa nga organizatori ka ardhur të enjten në adresë të Komitetit Olimpik të Kosovës. KOK-u në bashkëpunim me FPPK-n kanë kërkuar nga organizatori që pingpongistit Fatih Karabaxhaku t'i mundësohet pjesëmarrja me ftesë, në disiplinën individuale, pasi garuesve tanë i ishte mohuar pjesëmarrja në Kampionatin Evropian Individual të mbajtur në Alikante të Spanjës, vitin e kaluar. Qeveria e Spanjës nuk i kishte dhënë vizën hyrëse delegacionit tonë. Deri më tani KOK-u ka të konfirmuara dy ftesa për "Minsk 2019", një për boksieren Donjeta Sadiku dhe një për pingpongistin Fatih Karabaxhaku. Në javët e ardhshme pritet të konfirmohet pjesëmarrja edhe për garuesit e sporteve të tjera. Kosova është paraqitur edhe në Lojërat Evropiane "Baku 2015", në të cilat debutoi me medaljen e bronzit të fituar nga xhudistja Nora Gjakova.

Kosova, tri pozita më lart në renditjen e FIFA-s, Shqipëria një më poshtë

Prishtinë, 4 prill - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka shënuar rritje për tri pozita në ranglistën e re të FIFA-s, kurse Kombëtarja e Shqipërisë ka rënë për një pozitë. "Dardanët" barazuan në miqë-

sore me Danimarkën (2-2), në stadiumin "Fadil Vokrri", më pas barazuan edhe me Bullgarinë (1-1) në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020". Kurse Shqipëria pësoi humbje nga Turqia (0-2),

por më pas mposhti Andorrën (0-3) dhe ka rënë për një pozitë dhe tash renditet në pozitën e 62-të. Në pozitën e parë është Belgjika, pastaj renditen Franca, Brazili, Anglia, Kroacia, Uruguai,

Portugalia, Zvicra, Spanja dhe Danimarka. Ndërsa dy kombëtares e fuqishme, Argjentina dhe Gjermania, pozicionohen në pozitën e njëmbëdhjetë, përkatësisht të trembëdhjetë.



Hamiltoni, piloti më i paguar në Formula 1

LONDËR, 4 PRILL - Lewis Hamiltoni është "mbreti" i Formula 1. Sipas një renditje të publikuar sot nga "Formula Money", piloti britanik i Mercedesit është piloti më i paguar në historinë e Formulës 1, me 489 milionë dollarë. Kjo është shumë e arkëtuar nga britaniku në 12 vjet karrierë në garat e automobilizmit, mes rrogës

dhe premive që ka fituar që nga viti 2007, sezon kur debutoi në Formula 1. Në vendin e dytë renditet legjenda Michael Schumacher e pas tij spanjoli Fernando Alonso. I katërti Sebastian Vettel, ndërkohë që në "top 10" pilotët më të pasur janë gjashtë ferraristë. Ja 10 pilotët më të pasur të historisë së F1:

Lewis Hamilton (489 milionë dollarë), Michael Schumacher (464 milionë dollarë), Fernando Alonso (458 milionë dollarë), Sebastian Vettel (358 milionë dollarë), Kimi Raikkonen (331 milionë dollarë), Jenson Button (147 milionë dollarë), Ralf Schumacher (121 milionë dollarë), Jacques Villeneuve (115 milionë dollarë),



Felipe Massa (110 milionë dollarë), Rubens Barrichello (110 milionë dollarë).

Ramadani: Kemi ngritje të madhe në përfaqësueset U21 dhe U19

Prishtinë, 4 prill - Në prag të paraqitjes në garën e rëndësishme IHF Trophy Intercontinental, hendbollistët e përfaqësuesve U19 dhe U21 të Kosovës prej së hënës janë vendosur në Prishtinë dhe po stërviten nën mbikëqyrjen e shtabit teknik të përfaqësueses, në krye me përzgjedhësin Taip Ramadani. Gara IHF Trophy mbahet në Prishtinë prej 10 deri më 14 prill, ndërsa përfaqësuesja U21 ka rast të artë që me triumf në këtë garë ta sigurojë paraqitjen në botërorin e juniorëve që mbahet në verë në Spanjë. "Para dy javësh kemi kompletuar testet e përgjithshme të lojtarëve, ku kemi mbledhur një sasi të madhe informatash për përgatitjen fizike të lojtarëve të ekipeve U19 e U21. Kemi filluar t'i analizojmë shifrat dhe të bëjmë një krahasim me dy përfaqësueset elitare evropiane të këtyre grupmoshave. Disa nga informatat janë premtuese por, gjithashtu, po e shohim se ku kemi mungesa dhe do të mundohemi të shtjellojmë këto analiza me lojtarët dhe me klubet, që të jenë më të informuar se ku dhe si duhet të punohet në vazhdim", ka thënë Ramadani. "Po të hënën e të martën kishim stërvitjet e para me këto grupmosha dhe më la përshtypje përmirësimi i dukshëm në formë të shumë lojtarëve. Sidomos të grupmosha U19 kjo është më e dukshme, pasi para një viti kishte mungesa të mëdha. Ekipi U21 duket më i përbërë dhe vërejtja se ka një fokus të ri dhe seriozitet të shtuar në pothuajse i gjithë grupi", ka deklaruar Ramadani pas dy ditë stërvitje. Ai ka pranuar se shpresa dhe synimi



është që përfaqësuesja U21 ta fitojë garën IHF Trophy Intercontinental dhe të kualifikohet në kampionatin botëror që mbahet në Spanjë në muajin korrik. "Pothuajse të gjithë lojtarët që i kemi llogaritur i kemi në dispozicion për këtë kampionat. Jam i lumtur që grupmoshës U19, që përbëhet krejtësisht me lojtarë të klubeve të vendit, i është bashkuar Vilson Gojani, që është i lindur në Klinë, por jeton e luan në ligën elite të Italisë. Është lojtar i pozitës qendër, është i fuqishëm dhe i shpejtë. Në kombëtaren e grupmoshës U21 i është përgjigjur thirrjes Blend Dalladaku, që luan me juniorët e klubit elitë francez, Nantes. Është i fortë dhe mbrojtës i shkëlqyeshëm në qendër të zonës. Po ashtu, për herë të parë vjen edhe Albin Xhafolli që luan alo e djathtë. Albini është prodhim i akademisë së hendbollit të klubit të famshëm gjerman Gummersbach dhe këtë stinor, deri më tani, ka luajtur katër ndeshje në Bundesligë me këtë ekip. Kjo dëshmon se sa shumë ka fituar besim në të klubi gjerman", ka treguar Ramadani. Organizimi i IHF Trophy Intercontinental në Kosovë dësh-

mon për vlerësimin e lartë që ka IHF-ja ndaj FHK-së, ka thënë Ramadani, për të vazhduar. "Kjo është hera e tretë që fitojmë besimin e federatës ndërkombëtare për organizimin e kampionateve të mëdha ndërkombëtare. Këtë herë disa federata të tjera shprehën dëshirë të jenë nikoqire të kësaj gare, por Kosovës iu dha përgjegjësia edhe një herë. Për Kosovën kjo sjell dobi të mëdha. Kosovës i hapen dyer të rëndësishme ndërkombëtare në rrafshin sportiv. Kjo ngjarje sjellë përvojë të mëtejme për organizimin e garave ndërkombëtare, na mundëson edhe një herë mirëpritjen e ekipeve nga të gjitha anët e botës, duke përfshirë edhe ShBA-në, Australinë dhe Nigerinë. Ky kampionat krijon miqësi të reja sportive e diplomatike, sadopak stimulon ekonominë vendore dhe promovon shtetin tonë në dritë të mirë. Mirëpo dobia më e madhe është se shërben si frymëzim për rininë e Kosovës, jo vetëm nga pikëpamja sportive, por edhe në arena të tjera që kanë të bëjnë me organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare dhe mirëpritjen e miqve nga gjithë bota".

Houstoni marshon me Hardenin, Toronto synon kreun në Lindje



HOUSTON, 4 PRILL - Sfidë e fortë për kreun në Konferencën e Perëndimit, ku tri ekipe ndahen me nga një fitore mes tyre. Houstoni mundi 135-103 clippersat jashtë fushës, duke kërkuar kreun. Një ndeshje e dominuar nga ekipi tek-san, me të zakonshmin Harden që ishte shënuesi më i mirë, autor i 31 pikëve. Ai u mbështet edhe nga Pauli me 29 pikë e Capela me 24 pikë e 15 rebounde. Edhe Denveri

synon kreun në Perëndim, pas fitores 113-85 ndaj San Antonios, me Jokiçin që realizoi 20 pikë, ndërsa Morrisi e Beasley nga 19 secili. Në Lindje, skuadra e Torontos mundi 115-105 Brooklynin, ndeshje ku kanadezët kishin një epërsi të lehtë gjatë gjithë kohës dhe e merituan fitoren. Siakam me 28 pikë e Leonardo me 26 bënë diferencën në fushë për Toronton. Fiton edhe ekipi i Bostonit, që mundi 112-102

REZULTATET	
Detroit - Indiana	89-108
Orlando - New York	114-100
Washington - Chicago	114-115
Atlanta - Philadelphia	130-122
Brooklyn - Toronto	105-115
Miami - Boston	102-112
New Orleans - Charlotte	109-115
Dallas - Minnesota	108-110
Denver - San Antonio	113-85
Phoenix - Utah Jazz	97-118
Portland - Memphis	116-89
Clippers - Houston	103-135

Miamin, sfidë ku basketbollistët e Celticsit vuajtën shumë për të triumfuar. Më i miri në fushë ishte Haywardi me 25 pikë. Fitore në sekondat e fundit për Chicagon, që mposhti 115-114 Washingtonin, me 7 lojtarë të Buissit që realizuan mbi 10 pikë.

SHKURT

Mandzukiqi vazhdon me Juven

Sulmuesi Mario Mandzukiq ka rinovuar kontratën me skuadrën e Juventusit deri në vitin 2021. Klubi bardhezi ka dalë me një deklaratë pas nënshkrimit të kontratës së re me sulmuesin kroat. Mandzukiq iu bashkua Juventusit në verën e vitit 2015 teksa bardhezinjtë i paguan Atleticos së Madridit rreth 20 milionë euro. Në katër sezone në Serinë A ai ka arritur të realizojë 30 gola, duke qenë një lojtar i rëndësishëm për arritjen e objektivave të bardhezinjve. Paga e kroatit bëhet 4.5 milionë euro në sezon, ndërkohë që do të ketë edhe bonuse në varësi të paraqitjeve individuale dhe arritjes së objektivave të klubit. Juventusit kështu blindon një nga lojtarët kryesorë të skuadrës.

Gotze dëshiron t'i bashkohet Kloppit në Liverpool

Mario Gotze thotë se gjithmonë synon sfida të reja dhe ka lënë të kuptohet se një ribashkim me ish-trajnerit e tij të Borussia Dortmundi, Jurgen Klopp, mund të jetë i mundur në Liverpool. Fituesi i Kupës së Botës pati mundësinë ta shfrytëzonte këtë rast në vitin 2016, por nuk e bëri. Derisa largimi i tij nga Bayern Munichu po afrohej seç herë e më shumë, kishte pasur diskutime të ndryshme për klubin e tij të ardhshëm. Por, Gotze zgjodhi përfundimisht të kthehet në Dortmund, por vetëm pasi kishte biseduar me Kloppin. Kjo mund të ndodhë tani, megjithatë, pasi 26-vjeçari e ka rigjetur formën e tij kohëve të fundit duke e rikthyer reputacionin e dikurshëm. Ai ka kontratë me Dortmundin vetëm deri në vitin 2020 dhe e pranon se ende është në kontakt të vazhdueshëm me trajnerin e Liverpoolit. "Ai (Klopp) e dinte se unë doja të largohesha nga Bayern. Natyrisht, në folëm. Ai më njeh shumë mirë dhe e di se unë gjithmonë kërkoj sfida të reja. Unë flas shpesh me Klopp. Ai më solli në ekipin e tij të parë kur isha 17 vjeç dhe bëri gjithçka të mundur. Ne flasim vazhdimisht", ka thënë Gotze për "Bild".

Boca Juniorsi kërkon tre yje në Evropë

Boca Juniorsi po përgatitet për një sezon mjaft të nxehtë merkatoje, pasi presidenti Daniel Angelici ka ndërmend t'i sjellë disa yje në skuadër. Në shënjestrën e gjigantëve argjentinas janë Arturo Vidal, Alejandro Gomez dhe Lucas Biglia, të tre mbi 30 vjeç, por që mund t'i japin shumë skuadrës së Boca Juniorsit.

Luca Zidane huazohet te Baseli

Zinedine Zidane aktivizoi të birin, Luca, si titullar në sfidën e të dielës në mbrëmje ndaj Huescas, ndërsa pas takimit konfirmoi besimin te cilësitë e tij. Megjithatë, duke parë konkurrencën e fortë me emra si Courtois dhe Navas, Luca Zidane pritet të huazohet sezonin e ardhshëm te Baseli, për të luajtur rregullisht dhe fituar përvojë.

Sevilla vendos për blerjen e Silvas, Milani 'lakmon' Kjaerin

Pavarësisht se në pjesën e dytë të sezonit nuk është shfaqur në lartësinë e duhur, Sevilla duket se ka vendosur ta blejë kartonin e sulmuesit Andre Silva nga Milani. Problemi i vetëm për spanjollët është çmimi i lartë i vendosur në marrëveshjen që dy klubet arritën kur sulmuesi u huazua në Spanjë. Andaluzët kërkojnë që ta ulin disi shumën prej 36 milionë eurosh të kërkuar nga Milani, ndërkohë që kuqezinjve nuk u shkon përshtat kjo lëvizje, pasi paratë që pritet të fitojnë nga shitja e portugezit ata do të kërkojnë t'i investojnë sërish në merkato. Italianët janë të gatshëm që nëse Sevilla pranon të fusë në marrëveshje edhe mbrojtësin Simon Kjaer.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania "Abi Likaj" Sh.p.k.Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit, gurëthyesin dhe seperacionin në Krajë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.05.2019 në ora 11:00 në hapësirat e autoservis-Bife Leutrimi në Landovicë komuna e Prizrenit, do të organizohet debat publik nga kompania "Abi Likaj" Sh.p.k.Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit, gurëthyesin dhe seperacionin në Krajë komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Dëshmorët e Zatriqit"- Zatriq
Komuna: Rahovec
Data: 05.04.2019

Numri i kontratës: ESIP/SDG/092-CS/1.2	Emri i kontratës: Trajnimi i mësimdhënësve për TIK
---	---

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollën "Dëshmorët e Zatriqit"- Zatriq, Rahovec.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimit të mësimdhënësve për TIK

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: "Dëshmorët e Zatriqit"- Zatriq, Rahovec, më së largu deri më 15.04.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Shemsije Shala
Telefoni: 044 269 053
E-maili: diella8448@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica–Municipality of Mitrovica



Drejtoria Komonale e Arsimit

Nr. 07-11/01-0028512/19

Datë: 04.04.2019

M I T R O V I C Ē

Drejtoria Komonale e Arsimit në Mitrovicë, me propozimin e shkollave publike të komunës, në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Neni 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MPMS Nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, UA nr. 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, vendosi të publikoj këtë:

KONKURS PLOTËSUES

Për plotësimin e vendeve të punës në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta të komunës së Mitrovicës, si vijon :

Nr.	Niveli	Institucioni/shkolla	Vendi	Pozita	Nr. i pozitave	Vendi i lirë/Zëvendësim	Numri i orëve
1	SHML	Frang Bardhi	Mitrovicë	Mësimdhënës/e Kimi	1	Vendi i lirë	Normë e plotë
2	SHF	Bislim Imeri	Kçiq i madh	Mësimdhënës/e Cikël Klakor	2	Vende të lira	Norma të plota
3	SHMU	Abdullah Shabani	Mitrovicë	Mësimdhënës/e TIK	1	Vendi i lirë	Normë e plotë
5	SHMU	Abdullah Shabani	Mitrovicë	Ed. Fizike	1	Zëvendësim	Normë e plotë
6	SHMU	Migjeni	Mitrovicë	Mësimdhënës/e Informatikë	1	Vendi i lirë	Norma të plota
7	SHF	Mehë Uka	Bajgorë	Mësimdhënës/e Cikël Klakor	2	Vende të lira	Norma të plota
8	SHF	Shemsi Ahmeti	Zasellë	Mësimdhënës/e Cikël Klakor	1	Vendi i lirë	Normë e plotë
9	SHMU	Bedri Gjinaj	Mitrovicë	Mësimdhënës/e Ed. Muzikore	1	Zëvendësim	Gjysmë norme (10 orë)
10	SHMU	Bislim Hajdari	Kaqanollë	Mësimdhënës/e TIK	1	Zëvendësim	Normë e plotë
11	SHF	Elmaz Peci	Rahovë	Mësimdhënës/e Cikël klakor	1	Vendi i lirë	Normë e plotë

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Diploma (Çertifikata e diplomimit- nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e noterizuar nga organi kompetent;
- Ekstrakti i lindjes;
- Letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Vërtetimi nga gjykata se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për vepër penale;
- Dokumenti i përvojës së punës në arsim (nëse ka);
- Dëshmi të trajnimeve arsimore të akredituara nga MASHT-i (nëse ka).

Kushtet:

Për këto vende të punës kërkohet përgatitja adekuate profesionale, konform Udhëzimit Administrativ 10/2018 Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në kopje (dokumenti për kualifikimin profesional i noterizuar), të cilat nuk kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen me rastin e intervistimit.

Kandidatët që e kanë mbaruar shkollimin jashtë Kosovës duhet t'i kenë dokumentacionet e nostrifikuara.

Testi me shkrim për të gjithë kandidatët do të mbahet më datën 16.04.2019, në objektin e ri të shkollës model "Ismail Qemajli", në Bair, Mitrovicë. Testi fillon në orën 10:00 për të gjithë kandidatët. Kandidatët me vete duhet të kenë dokument identifikimi.

Udhëzim për konkurim:

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në komunë, zyra nr.10 – (Qendra për Shërbime me Qytetarë).

Me një aplikacion mund të konkurohet vetëm për një vend pune.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në gazetë dhe web faqe të komunës.

Dokumentacioni i pa kompletuar dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të shqyrtohet.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Drejtoria Komonale e Arsimit

Nr. 07-111/01-0028057/2019
dt. 04. 04. 2019.

M i t r o v i c ë

Në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, nenit 11 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/2014, pas Autorizimit nga MAP/DASHC, Komuna e Mitrovicës së Jugut, shpall:

KONKURS

Institucioni : Komuna e Mitrovicës së Jugut
Drejtoria: Drejtoria e Arsimit

Titulli i vendit të punës:

1. Drejtor i Gjinnazit "Frang Bardhi" në Mitrovicë
2. Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Nonda Bulka" në Mitrovicë
3. Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Jusuf Rexha" në Koshtovë
4. Drejtor i Shkollës së Muzikës (dy nivelet) "Tefta Tashko" në Mitrovicë
5. Zëvendës drejtor i SHML ekonomike "Hasan Prishtina" në Mitrovicë
6. Zëvendës drejtor i SHML teknike "Arkitekt Sinani" në Mitrovicë
7. Drejtor i Institucionit Edukativ Parashkollor (QF). "Gëzimi Ynë" në Mitrovicë
8. Zëvendës drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Fazli Grejçevci" në Shipol
9. Zëvendës drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Migjeni" në Mitrovicë
10. Zëvendës drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Gj. K. Skënderbeu" në Mitrovicë

- **Kategoria funksionale për drejtor të SHML-Gjinnaze /Grada: Koefficienti 8.4**
- **Kategoria funksionale për drejtor të SHFMU /Grada: Koefficienti 7.8**
- **Kategoria funksionale për zëvendës drejtor të SHFMU/Grada : 7.2**
- **Kategoria funksionale /Grada: për zëvendës drejtor të SHML profesionale ko. 7.8**
- **Niveli i koefficienteve A-7.8 (Koefficienti) për drejtor të Shkolles artistike koficj. 8.4**
- **Kategoria funksionale /Grada: për drejtor të institucionit parashkollor koficjent**
- **Niveli i koefficienteve A-7.8 (Koefficienti) për drejtor të Institucionit parashkollor 7.8**

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

1. Drejtori i institucionit menaxhon punën e përgjithshme të shkollës dhe ndihmon në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave, kurse zëvendës drejtori ndihmon drejtorin e institucionit në realizimin e objektivave;
2. Drejtori menaxhon stafin e shkollës, dhe në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore, kurse zëvendës drejtori ndihmon në punën e tij;
3. Ndihmon shkollën në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
4. Menaxhon ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve në fushën e edukimit, kurse zëvendës drejtori e mbështet dhe përkrah atë në punë;
5. Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me zhvillimin e institucionit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
6. Ekzaminon dhe ofron komente rreth rregulloreve dhe koordinohet me Drejtorinë e Arsimit për hartimin e rregulloreve shkollore;
7. Koordinon punën dhe bashkëpunon me stafin tjetër në institucion dhe është përgjegjës për të gjitha aktivitetet e nxënësve, mësimdhënësve në shkollë, personelit profesional dhe ndihmës, duke kryer me përpikëri detyrat lidhur me kurrikulen;
8. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara;
9. Mban 10 (dhjetë) orë mësimi në javë, nëse numri i nxënësve në shkollë është nën 250 nxënës.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit;
4. Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit;
5. Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim;

Kohëzgjatja e emërimit: katër (4) vite.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga dita e shpalljes.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën Nr.10 në Komunën e Mitrovicës. Për secilin pozitë duhet të aplikohet në mënyrë të veçantë. Së bashku me aplikacion duhet të dorëzohen edhe këto dokumente në një rreth prej gjuhëve zyrtare të komunës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 028 – 532 104

1. Ekstraktin e lindjes;
2. Diplomen e fakultetit të kryer për nivelin përkatës (E vërtetuar);
3. Dëshminë për përvojën e punës;
4. Portofolin profesional (shih Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr. 08/2014- Shtojca G)
5. Letërreferencë nga një institucion publik-kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë). Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për angazhimet paraprake);
6. Planin Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, arial) sipas udhëzimeve të MASHT-it.
7. Njohuri dhe përvojë substanciale për fushën e edukimit;
8. Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
9. Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
10. Shkathësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar punën e ekipit;
11. Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Eörd, Exel, Poëer Point, Access.
12. Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
13. Dëshminë se nuk është nën hetime.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Kërkesat e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Në intervistë do të kuarjohen dhe ftohen të gjithë kandidatët konkurrent të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Komuna e Mitrovicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Opštinska direkcija za obrazovanje

Br. 07-111/01-0028057/2019
dt. 04. 04. 2019.

M i t r o v i c a

Na osnovu člana 5 Zakona br. 03 / L-068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo, člana 20 Zakona br. 04 / L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju, članova 11 i 18 Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, Administrativnog uputstva MON1a br. 08/2014, nakon ovlašćenja od strane MJA / DCSA, Opština Južna Mitrovica, objavljuje:

OGLAS

Institucija : Opština Južna Mitrovica
Direkcija: Direkcija Obrazovanja

Naziv radnog mesta:

1. Direktor Gimnazije "Frang Bardhi" u Mitrovici
2. Direktor Osnovne srednje niže škole "Aziz Sulejmani" u Mitrovici
3. Direktor Osnovne srednje niže škole "Jusuf Rexha" u Koshtovu
4. Direktor Muzičke škole (dva nivoa) "Tefta Tashko" u Mitrovici
5. Zamenikdirektora SVŠ ekonomska "Hasan Prishtina" u Mitrovici
6. Zamenikdirektora SVŠ tehnička "Arkitekt Sinani" u Mitrovici
7. Direktor Predškolske obrazovne institucije (DO). "Gëzimi Ynë" u Mitrovici
8. Zamenikdirektora Osnovne srednje niže škole "Fazli Grejçevci" u Šipolje
9. Zamenikdirektora Osnovne srednje niže škole "Migjeni" u Mitrovici
10. Zamenikdirektora Osnovne srednje niže škole "Gj. K. Skënderbeu" u Mitrovici

- **Funkcionalna kategorija za direktora SVŠ-Gimnazija /Grada: Koefficient 8.4**
- **Funkcionalna kategorija za direktora OSNS / Grada: Koefficient 7.8**
- **Funkcionalna kategorija za zamenikadirektora OSNS/Grada : 7.2**
- **Funkcionalna kategorija/Grada: za zamenikadirektora profesionalne SVŠ ko. 7.8**
- **Nivo koefficienta A-7.8 (Koefficient) za direktora umetničke škole koficj. 8.4**
- **Funkcionalna kategorija /Grada: za direktora Predškolske obrazovne institucije koficjent**
- **Nivo koefficienta A-7.8 (Koefficienti) për drejtor të Institucionit parashkollor 7.8**

Glavne dužnosti i odgovornosti:

1. Direktor ustanove upravlja opštim radom škole i pomaže u postavljanju ciljeva i izradi plana rada za ispunjenje ovih ciljeva, dok zamenik direktora pomaže direktoru institucije u postavljanju ciljeva;
2. Direktor rukovodi školskim osobljem i u saradnji sa Direkcijom za obrazovanje organizuje rad dodeljivanjem dužnosti zavisnim licima, pruža uputstva i nadgleda rad osoblja za pružanje kvalitetnih proizvoda i usluga dok pomoćnik direktora pomaže u njegovom radu;
3. Pomaže školi u proceni internih procesa i procedura i preporučuje promene/poboljšanja kako bi se povećala efikasnost i kvalitet rada;
4. Upravlja pružanjem usluga i aktivnosti u oblasti obrazovanja, dok zamenik direktora ga podržava na poslu;
5. Razvija i predlaže politike vezane za razvoj institucije i nadzire njihovu implementaciju;
6. Ispituje i daje komentare na propise i koordinira sa Direkcijom za obrazovanje za izradu školskih propisa;
7. Koordinira rad i saraduje sa drugim osobljem u instituciji i odgovoran je za sve aktivnosti učenika, nastavnika u školi, stručnog osoblja i facilitatora, izvršavajući tačno zadatke vezane za nastavni plan i program;
8. Vršiti redovnu procenu osoblja pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuku za obavljanje njihovih dužnosti u skladu sa propisanim standardima;
9. Nedeljno održava 10 (deset) časova ako je broj učenika u školi ispod 250 učenika.

Uslovi za učeće u regrutisanju: Svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost da deluju imaju pravo da se prijave, i koji imaju potrebnu školsku spremu i fizičke veštine potrebne za odgovarajuću poziciju.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Kandidati moraju ispunjavati sledeće uslove:

1. Biti državljanin Republike Kosova;
2. Imati završeno najmanje univerzitetsko obrazovanje (najmanje kvalifikaciju 240 ECTS/4 godine univerzitetskog obrazovanja);
3. Da imaju pravilnu licencu za nastavnike ili da budu u postupku licenciranja;
4. Da imaju najmanje 3 godine radnog iskustva u obrazovanju ili obrazovnim institucijama;
5. Da su uspešno završili akreditovani program stručnog osposobljavanja za upravljanje, administraciju i menadžovanje;

Trajanje imenovanja: četiri (4) godine.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 15 dana nakon objavljivanja konkursa:

Podnošenje prijave: Prijave se primaju i podnose u kancelariji br.10 u opštini Mitrovica. Za svaku poziciju treba se posebno prijaviti. Zajedno sa prijavom, ova dokumenta moraju biti dostavljena na jednom od službenih jezika opštine. Telefonski kontakti se mogu obavljati na 028 - 532 104


1. Izvod rođenih;
2. Fakultetsku diplomu završenu za odgovarajući nivo (sertifikovanu);
3. Dokaz o radnom iskustvu;
4. Profesionalni portfolio (vidi Administrativno uputstvo MONT-a br. 08 / 2014- Aneks G)
5. Referentno pismo javne institucije (kao što su MONT, ODO, školski odbor, prethodni poslodavac, institucije visokog obrazovanja). Referentna pisma treba da imaju dokaze za prethodno angažovanje);
